



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.10.2021, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Enkelejd Alibeaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor.

2. Zgjedhja e sekretarit të komisionit.

3. Përcaktimi i mbledhjes së ardhshme të komisionit.

Marrin pjesë:

Enkelejd Alibeaj, Toni Gogu, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Aurora Mara, Klevis Xhoxhi, Nasip Naço, Petro Koçi, Bardhyl Kollçaku, Gazment Bardhi, Oerd Bylykbashi, Ferdinand Xhaferraj, Ervin Salianji, Petrit Vasili, Xhemal Qefalia, Etjen Xhafaj dhe Arbi Agalliu.

Mungojnë:

Kreshnik Çollaku.

HAPET MBLEDHJA

Enkelejd Alibeaj – Duke qenë se edhe media është gati dhe kuorumi i komisionit hetimor është i plotë, ju njoftoj se sot, për shkak të mungesës së anëtarit të komisionit, zotit Çollaku, në vend të tij do të jetë prezent zoti Arbi Agalliu, i cili është dhe një nga anëtarët zëvendësues, përcaktuar nga ana e Partisë Demokratike.

Besoj se nga ana e anëtarëve të Partisë Socialiste nuk ka asnjë zëvendësim, zoti nënkryetar, dhe jeni me formacion të plotë. Dakord.

Sipas rendit të ditës, i cili u deklarua që në mbledhjen e parë konstituente të këtij komisioni, ezauruam pikat e para dhe kemi ngelur në pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor. Kujtoj këtu që në mbledhjen e parë konstituente kemi rënë dakord që dy përfaqësues, njëri nga Partia Socialiste, tjetri nga Partia Demokratike, të arrinin të gjenin gjuhën e përbashkët dhe dakordësinë për draftin e rregullores, të depozituar nga ana ime, në pozicionin e kryetarit të komisionit.

Në këto kushte, pa humbur kohë, do të doja t'ua jepja fjalën dy përfaqësuesve, zotit Naço dhe zotit Salianji, për rezultatin e bashkëpunimit dhe gjetjes së gjuhës së dakordësisë për ndryshimet eventuale të rregullores.

Zoti Naço...

Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Faleminderit, kryetar!

Së pari, edhe për shkak se media ka pasur goxha interes në lidhje me mosmarrëveshjet tona për vazhdimin e mbledhjes, doja t'ju informoja që, në zbatim të ligjit për komisionin hetimor dhe Rregullores së Kuvendit, që janë dy dokumentet bazë mbi të cilat po zhvillojmë veprimtarinë tonë, kërkojmë që rendi i ditës të hidhet në votim. Është komisioni ai i cili miraton zhvillimet e punimeve. Ju lutem, lehtësojeni këtë dhe të zbatojmë ligjin!

Së dyti, për sa i përket rregullores ne jemi tërësisht dakord, pra shprehim dakordësinë tonë që të vazhdojmë me shqyrtimin e saj dhe, përsëri në zbatim të Rregullores së Kuvendit, propozojmë që diskutimi i rregullores të fillojë me miratimin në parim dhe më pas të vazhdojmë me miratimin nen për nen të saj. Pra, duam ta miratojmë rregulloren një orë e më parë, që të vazhdojmë, sepse jemi mbledhur për të hetuar.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Me sa kuptova, e para, ju kishit një kërkesë procedurale, më korrigjoni nëse nuk jam i saktë, që rendin e ditës ta hedhim në votim.

Toni Gogi – Kisha dy kërkesa procedurale.

E para, rendi i ditës së sotme të votohet nga komisioni, sepse nuk u hodh në votim në mbledhjen e mëparshme. Kështu që të paktën ta hedhim sot në votim, që të dimë se cili është rendi i ditës dhe ta shterojmë atë.

E dyta, kisha një kërkesë që të vijojmë me miratimin në parim të rregullores dhe me diskutimin nën për nën të saj.

Enkelejd Alibeaj – Dakord.

Po, zoti Bardhi.

Gazmend Bardhi – Zoti kryetar, për miratimin e rregullores sigurisht që procedura është ajo dhe nuk ka nevojë ta hedhim në votim, nuk është as kërkesë procedurale që do të miratohet në parim, nën për nën dhe në tërësi, sepse kjo është procedura me të cilën vepron çdo komision parlamentar.

Për sa i përket votimit të rendit të ditës, nuk ka asnjë rregull as në ligj, as në Rregulloren e Kuvendit. Përcaktimi i rendit të ditës është kompetencë e kryetarit të komisionit, siç është për funksionimin e parlamentit kompetencë e Kryetarit të Kuvendit. Nuk e votojmë në as në seancë, as në komision rendin e ditës. Sigurisht, secili prej anëtarëve të komisionit ka të drejtë të propozojë te kryetari përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës, por nuk votohet rendi i ditës, aq më tepër kur ne kemi përpara një rend dite që ka ngelur nga mbledhja e parë e këtij komisioni. Pra, miratimi i rregullores dhe zgjedhja e sekretarit të komisionit janë çështje të bartura nga mbledhja e kaluar. Kështu që besoj se nuk ka nevojë të vonohemi më shumë. Kemi humbur një ditë kohë, për shkak të mungesës së kolegëve të maxhorancës në mbledhjen e shkuar. Të vijojmë menjëherë me shqyrtimin e rregullores.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Po, zoti Bylykbashi.

Besoj se çështja është e qartë, por mund të shpreheni.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të bisedave, edhe nga eksperiencat që kemi me komisionet parlamentare dhe ato të posaçme e hetimore, besoj se një kërkesë e tillë është e pavend. Për më tepër, sot kemi dy kërkesa, që burojnë drejtpërdrejt nga ligji. Miratimi i rregullores dhe zgjedhja e sekretarit janë dy kërkesa që i ka ligji. Të votosh ligjin në komision është absurde. Për rrjedhojë, besoj se kjo është e pavend, aq më tepër edhe përcaktimi i mbledhjes së komisionit është diçka krejt e panevojshme për t'u diskutuar. Kështu që të ecim para.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Ne nuk po bëjmë një kërkesë për të hedhur në votim rendin e ditës se nuk jemi dakord me të, që ta qartësojmë këtë. Siç e tha edhe zoti Gogu, ne duam të vazhdojmë punën dhe të bëjmë atë për të cilën është ngritur komisioni, pra të vijojmë hetimin.

Duke qenë se këtu nuk është respektuar këshillimi ndërmjet kryetarit dhe nënkryetarit të komisionit sa i takon datës, orës dhe rendit të ditës, për ta vënë këtë komision në shina dhe në përputhje me rregulloren, kërkuam të votohet rendi i ditës.

Nëse nuk doni ta hidhni në votim, nuk ka ndonjë problem. Ne jemi dakord me rendin e ditës dhe do ta votonim po ta hidhnit në votim, por kjo ishte thjesht për të vënë punën e komisioneve në udhën e ligjshmërisë, edhe të procedurës, siç e parashikojnë të gjitha dokumentet mbi të cilat veprojnë komisionet hetimore.

Kështu që për ne nuk ka problem. Për pjesën tjetër pastaj le të vijojmë sipas kërkesës së zotit Gogu dhe besoj se të gjithë janë dakord.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Ju faleminderit për sqarimin tuaj edhe për publikun!

Rendi i ditës së mbledhjes së sotme është vazhdim i ezaurimit të rendit të ditës së mbledhjes së parë konstituuese. Siç ju e mbani mend mirë, rendi i ditës kishte 7 pika, nga të cilat kemi ezauruar 4 pikat e para dhe kanë ngelur 3 pikat e fundit, konkretisht: shqyrtimi dhe miratimi i rregullores; zgjedhja e sekretarit të komisionit; përcaktimi i mbledhjes së radhës.

Ju kujtoj se në mbledhjen e parë ne e ndërpreme ezaurimin e të gjithë rendit të ditës, i cili, sipas ligjit, në mbledhjen e parë i takon kryetarit të komisionit, dhe e bëmë këtë me kërkesën tuaj, sepse, siç e mbajmë mend të gjithë, madje me propozimin e zonjës Bushka, edhe sipas traditës së mëparshme, për çështje të rregullores, duke qenë edhe në frymën e konstruktivitetit, caktuam dy përfaqësues, një nga ana juaj, zotin Naço, dhe një nga grupi ynë, zotin Saliانji, të cilët bazuar në draftin e rregullores së depozituar prej meje, të mund të gjenin dakordësinë e tyre.

Ju kërkuat kohë. Ne ramë dakord t'ju jepnim dy ditë kohë, deri në datën 20 tetor, për konsultimin, për të qenë edhe korrektë, si në mbledhjen e parë konsultuese/konstituuese. Unë kam komunikuar me shumë dashamirësi dhe kam gjetur të njëjtën dashamirësi edhe nga zoti Gogu për caktimin e orës dhe të datës, pra ditën tjetër të mbledhjes, të kërkuar prej jush, datën 20 tetor, e caktuam këtu. E vetmja gjë që ne lamë në këshillim me zëvendëskryetarin, do të ishte orari. Gjatë asaj dite unë, jam u vura në dijeni nga zoti Saliانji, që zoti Naço ka

paraqitur një sërë amendamentesh. I është kthyer përgjigje nga zoti Salianji dhe pas atij momenti kam komunikuar menjëherë me ju, zoti Gogu, për caktimin e orarit. Ju kam propozuar orën 15:00 të datës 20. Më pas, nuk dua t'i bëj më tepër publike, sepse janë tashmë, ndodhi ajo që ndodhi. Unë uroj të mos ndodhë më, sepse, nëse kemi një detyrim, pavarësisht të gjitha dallimeve, ndasive, opinioneve, detyrimi i vetëm që kemi ne është t'i bindemi ligjit dhe vendimit të komisionit për t'u mbledhur dhe për të çuar përpara veprimtarinë e komisionit.

Rendi i ditës është i përcaktuar, madje jo sipas dëshirës sime si kryetar, por i përcaktuar nga ligji. Ne kemi ezauruar 4 pika të rendit të ditës dhe kanë ngelur edhe 3.

Pika e radhës së rendit të ditës është pikërisht shqyrtimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit. Meqenëse ramë dakord dhe caktuam dy përfaqësues, një nga grupi juaj, një nga grupi ynë, është e udhës që para diskutimit në parim, ku do të ndjekim të gjitha hapat proceduralë, sepse jemi të detyruar, sipas Rregullores së Kuvendit, për miratimin e rregullores, të kemi një relativ prej dy përfaqësuesve tanë.

Jeni të lutur, zoti Naço dhe zoti Salianji, të na bëni me dije se cili është produkti i bashkëpunimit tuaj.

Zoti Naço, meqenëse ishte kërkesa juaj, po ju drejtohem juve së pari.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i përket rendit të ditës, Rregullorja e Kuvendit e ka të përcaktuar qartë. Pra, kur Konferenca e Kryetarëve përcakton rendin e ditës, dhe kur nuk bien dakord, kalohet në seancë; të njëjtën gjë kemi kërkuar edhe për këtë komision, që ju nuk keni të drejtë të caktoni vetëm rendin e ditës.

Nëse do të lexojmë Rregulloren, të cilën e kemi të dy përpara, nuk e keni ju këtë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ligji, edhe Rregullorja.

Nëse doni, këtu është Rregullorja. Mund ta lexojmë, të jemi të qartë, ju, ne dhe të gjithë.

Pikën e dytë, për të cilën ramë dakord unë dhe zoti Salianji të diskutonim për rregulloren, i kemi dërguar amendamentet tona zotit Salianji, i cili ka bërë komente. Pas komenteve që janë bërë nga ana ime si përfaqësues i maxhorancës, anëtarët e tjerë të këtij komisioni kanë bërë komente të tjera dhe ia kanë dërguar dje zotit Salianji. Si procedurë.

Për pjesën tjetër, besoj se zoti Gogu u shpreh qartë: të eliminojmë pjesën e parë të diskutimit në parim për rregulloren dhe të jemi të gjithë dakord me zotin Gogu, ta kalojmë

këtë fazë në parim, të kalojmë nën për nën me nenet që ne jemi dakordësuar dhe çfarë ngelet t'i diskutojmë për të kapur kohën e humbur.

Nëse ju doni të bëni retorikë, këtu jemi.

Enkelejd Alibeaj – Po, zoti Salianji.

Ervin Salianji - Siç u dakordësua në mbledhjen e parë me kërkesën e përfaqësuesve të Partisë Socialiste të maxhorancës, ne duhet të dakordësoheshim dhe të vinim me një produkt të dakordësuar në këtë komision për propozimet apo në lidhje me ndryshimet që propozonte secili për rregulloren e propozuar apo të hartuar sipas ligjit nga kryetari i komisionit hetimor.

Ka pasur disa propozime, të cilat e cenojnë në thelb jo vetëm veprimtarinë e komisionit dhe të secilit prej deputetëve në komision, por edhe propozimet që bien ndesh me ligjin. Pra, për secilën prej këtyre pikave, te neni 7 kërkohet të ketë një reformulim, i cili bie ndesh me pikën 6 të draftrregullores, ku është cituar neni 12, pika 4 e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”. Te neni 10 propozohet të shtohet një nen me këtë përmbajtje: “1. Komisioni hetimor i merr vendimet në përputhje me kërkesat e neneve 12 dhe 13 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore” dhe “2. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, propozimi apo projektvendimi quhet i pezulluar dhe rimerret në shqyrtim në mbledhjen pasardhëse. Në rast se edhe në mbledhjen pasardhëse votat ndahen në mënyrë të barabartë, propozimi ose projektvendimi quhet i rrëzuar”. Ky është propozimi i maxhorancës. Sipas ligjit nr. 8891/2002, Rregullorja e Kuvendit nuk përmban përcaktime për rastet e barazisë së votave, por nëse do t'i referohemi ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike”, në nenin 15, pika 1 parashikohet se në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e kryetarit është vendimtare dhe ne mendojmë se duhet të jetë kështu edhe në këtë rast.

Në nenin 11 propozohet të riformulohet dhe të thuhet: “Të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Rregullores vendosen në rendin e ditës sapo paraqiten, dhe shqyrtohen menjëherë nga komisioni”. Asgjë nuk ndryshon në thelb, nuk ka arsye të kemi ndërhyrje.

Në nenin 13 propozohet që votimi të bëhet i fshehtë ose nominal, sipas përcaktimeve të neneve 59 dhe 60 të Rregullores së Kuvendit. Kur komisioni vendos për votim, mbledhja e komisionit ndërpritet për kohën e nevojshme për përgatitjen e procedurave të votimit. Thuhet se ky propozim bëhet me qëllim harmonizimin dhe përcaktimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore, ndërkohë që për ne, pika 5 është një reformulim i pikës 3, që i referohet drejtpërdrejtë nenit 13 të ligjit nr. 8891/2002. Duhet të sjellim në vëmendje

se mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisioneve hetimore rregullohet nga ligji i posaçëm dhe vetëm për aspekte që nuk rregullohen nga ligji zbatohet Rregullorja e Kuvendit. Pra, Rregullorja ka një funksion komplementar në raport me ligjin e posaçëm. Në këtë kuptim, kur dispozita e brendshme e komisionit është e harmonizuar me ligjin e posaçëm, nuk ka nevojë për asnjë riformulim të mëtejshëm.

Në propozimet e reja, që janë dërguar dje shumë vonë, rreth orës 21 të mbrëmjes, nga përfaqësuesit e Partisë Socialiste, kërkohet që të riformulohet neni 14. Këtu duket se është i gjithë sikleti, merakuri apo e gjithë përpjekja e përfaqësuesve të maxhorancës, të cilët kërkojnë të kufizojnë me rregullore të drejtat që i jep ligji. Pra, këta kërkojnë t'i nënshtrohen vullnetit të përfaqësuesve të maxhorancës kërkesat, të cilat ligji ia njeh qartësisht çdo deputeti dhe opozitës.

Neni 14 “Kërkimi i të dhënave”, propozohet që të riformulohet në këtë formë: “Anëtarët e komisionit kanë të drejtë t'i kërkojnë komisionit të marrë të dhëna, informacione ose të dokumente zyrtare, të pyes dëshmitarë për të sqaruar rrethana dhe fakte të ndryshme, që lidhen me çështjen e veçantë në hetim, të mbledhë dhe të shqyrtojë dokumente dhe prova të tjera shpresore.

Kërkesat sipas pikës 1 të këtij neni i drejtohen kryetarit ose në mungesë, me autorizim të tij, zëvendëskryetarit, i cili i paraqet në mbledhjen më të parë të komisionit. Komisioni shprehet me vendim të ndërmjetëm për to”. Këtë nuk e kuptoj, sepse propozimi është i paqartë dhe e kanë lënë me *bold*. “Në çdo rast kërkesa duhet bëhet e arsyetuar për veprime procedurale që do të ndërmerren nga komisioni me vendim të ndërmjetëm për të sqaruar një çështje të veçantë apo për marrjen e çdo të dhëne, dokumenti apo fakti, që shërben për nxjerrjen e konkluzioneve të hetimit.

4. Kërkesa zyrtare drejtuar titullarëve të institucioneve publike për të dhëna, informacione apo dokumente zyrtare, thirrja e dëshmitarëve për të sqaruar rrethana dhe fakte, si dhe shqyrtimi, mbledhja e dokumenteve dhe e provave të tjera shpresore pranë institucioneve hartohen nga sekretaria teknike, firmosen nga kryetari, kundërfirmosen nga zëvendëskryetari, si dhe përcillen në protokoll nga sekretari. Këto kërkesa nënshkruhen nga kryetari dhe kopjet e tyre i dërgohen për dijeni paraprakisht zëvendëskryetarit dhe/ose të gjithë anëtarëve të komisionit.

Organet kompetente që disponojnë këto të dhëna dhe dokumente janë të detyruar që t'ia përcjellin zyrtarisht komisionit, sipas kërkesës së tij, brenda afatit të përcaktuar në kërkesën zyrtare për informacion”.

Pikat 2 dhe 3 të këtij propozimi vijnë në kundërshtim me nenin 13, pika 4, të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002, pasi synojnë të kufizojnë të drejtën që ka çdo anëtar i komisionit për hetime ose marrje provash, duke kërkuar që t'i nënshtrohet votimit me votime të ndërmjetme”.

Ligji e ka të parashikuar qartë këtë të drejtë, pa iu nënshtuar asnjë procedure votimi apo vendimmarrje të asnjë vullneti dhe as të komisionit. Pra, pikat 2 dhe 3, të cilat ne i kemi ridërguar kur ka ardhur propozimi fillestar, vijnë në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar të ligjit nr. 8891/2002, rrjedhimisht janë të papranueshme dhe në kundërshtim me ligjin. Rregullorja e komisionit nuk mund t'u mohojë anëtarëve të komisionit një të drejtë thelbësore që ua ka njohur ligji.

Te neni 17, “Thirrja për të dëshmuar”, kërkohet që të ketë një riformulim tjetër me këtë formë:

“Komisioni nëse vlerëson se informacioni shkresor është i pamjaftueshëm me vendim të ndërmjetëm (edhe këtu kërkohet t'i nënshtrohet votës), thërret dëshmitar për të dëshmuar përpara komisionit për ngjarje dhe fakte që ai apo ajo di në lidhje me çështjen e objektit të hetimit.

Koha e thirrjes për të dëshmuar përcaktohet sipas nevojave të hetimit dhe në përputhje me kalendarin e përcaktuar në planin e hetimit të miratuar nga komisioni.

Në zbatim të vendimi të ndërmjetëm, sipas pikës 1 të këtij neni, sekretariati merr masa për njoftimin e personave dëshmitarë. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën e seancës, vendin, cilësinë në të cilën thirret personi, çështjen për të cilën dhe cilat thirret të dëshmojë, si dhe nënshkrimin e kryetarit të komisionit dhe zëvendëskryetarit”.

Edhe në këtë rast një të drejtë që neni 13, pika 4, ia njeh çdo anëtari për kryerjen e hetimeve, pra çdo anëtari të këtij komisioni, e cila përfshin domosdoshmërisht edhe thirrjen e dëshmitarëve, ka përpjekje për t'ia nënshtuar vendimmarrjes së shumicës dhe për të kufizuar një të drejtë që ligji ia njeh çdo anëtari. Qëllimi është i qartë, nëpërmjet procedurave të votimit shumica të pamundësojë kryerjen e veprimeve hetimore, marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve. Por kjo nuk është as çështje dëshire dhe as qëllimi, por është qartësisht një çështje e zbatimit të ligjit me përpikëri. Ne këtë kemi propozuar në këtë rast, që të kishte dakordësi duhej hequr, por është risjell përsëri mbrëmjen e djeshme, në orët e vona, ky propozim pa pasur asnjë reflektim.

Neni 19 propozohet që të riformulohet në këtë formë:

1. “Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë t'u bëjë pyetje personave të thirrur për të dëshmuar.

2. Anëtari i komisionit e merr fjalën për të bërë pyetje pas dhënies së kësaj të drejte nga kryetari.

3. Kryetari dhe çdo anëtar i komisionit që pyet nuk ka të drejtë të japë konkluzione në seancën e pyetjeve.

4. Kryetari dhe çdo anëtar i komisionit nuk kanë të drejtë të komentojnë njëri-tjetrin për karakterin e pyetjeve që u drejtohen personave të thirrur.

5. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të paraqesin me radhë, një folës nga opozita dhe një nga pozita, pyetje dhe të rimarrin fjalën për të bërë pyetje, për të kërkuar sqarime dhe saktësime të mëtejshme vetëm pasi të ketë përfunduar radha për secilin nga anëtarët”.

Propozimi ynë ka qenë që neni 12, pika 1, i ligjit nr. 88 91/2002 dhe neni 23, pika 1, i Rregullores së Kuvendit parashikon se kryetari thërret, organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit. Në këtë kuptim kryetari është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së komisionit. Ndërhyrjet e tij nuk kanë për qëllim të diktojnë qëndrimet apo pyetjet e anëtarëve, por sigurimin e funksionit të tij si drejtues i komisionit. Prandaj kufizime të tilla vijnë në kundërshtim me frymën e ligjit dhe të rregullores dhe rrjedhimisht kjo për ne është e papranueshme dhe duhet hequr.

Pra, thashë vetëm elementet kryesore, për të mos u zgjatur dhe për të mos lexuar të gjitha ato që nuk jemi dakord apo mund të kemi rezerva, por ato që thelbësisht cenojnë mbarëvajtjen e punës së këtij komisioni, bien ndesh me ligjin dhe tregojnë se të gjithë përpjekjet fillestare të ditës së parë dhe të mungesës në mbledhjen e dytë të dakordësuar mes palëve kanë vetëm një qëllim, që punën e këtij komisioni ta zvarrisin, të mos lënë të bëhen hetime të plota, siç e parashikon ligji, dhe të pamundësojnë hetimin e masakrës zgjedhore.

Ajo që propozojmë në këtë rast, meqenëse nuk ka dakordësi për këtë, po e quaj draftrregullore, e cila duhej të dakordësohej, sipas miratimit paraprak që u bë në mbledhjen e kaluar nga 2 përfaqësuesit, unë mendoj se, qoftë propozimet e përfaqësuesve të Partisë Socialiste, qoftë propozimet tona nuk kanë vlerë. Ne duhet të diskutojmë dhe të hedhim në votim në parim rregulloren e propozuar nga kryetari i komisionit, që, siç e parashikon ligji, e harton dhe e propozon në mbledhjen e komisionit, duke mos marrë parasysh asnjë prej elementeve të kësaj draftrregulloreje, që mes palëve nuk është e dakordësuar aspak.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Për t’ju bërë një përmbledhje të asaj çfarë thanë zoti Naço dhe zoti Salianji, me aq sa kuptova, ju nuk keni rënë dakord mbi draft-rregulloren e propozuar

prej meje në mbledhjen e parë konstituuese nuk keni gjetur gjuhën e përbashkët, kjo është e qartë, blateale me sa duket.

Ka një propozim nga zoti Salianji, që për sa kohë nuk ka një dakordësi ndërmjet dy përfaqësuesve të të dyja palëve, zotit Naço dhe zotit Salianji, këto nuk janë më propozime, të cilat mund t'ia shtrojmë kësaj tryeze, gjithmonë në përmbushje të vendimit të mbledhjes së parë, ku ne caktuam dy përfaqësues që të merreshin vesh nëse drafti i vetëm, i cili është për t'u diskutuar dhe votuar është ai i propozuar nga ana e kryetarit. Ky është propozimi.

Zoti Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit!

Së pari, për procedurë, mendoj se do të ishte e udhës që procedimi i miratimit të Rregullores të vijonte duke e shqyrtuar atë nen për nen, pas atij kalimi formal në parim. Në rastet ku nuk kemi dakordësi, t'i kapërcejmë. Pra, t'i mbarojmë të gjitha nenet për të cilat jemi dakord dhe më pas, në fund, të lëmë të gjitha nenet për të cilat kemi ende diskutime dypalëshe.

Së dyti, në parim do t'ju thosha që ky është një komision mbipartizan, pra nuk është një komision i njëanshëm, që do të thotë hetimi nuk është partiak, por është parlamentar, si dhe nuk është zëvendësues në raport me hetimet që kryejnë institucionet e tjera ligjzbatuese.

Së treti, do t'i ftoja të gjithë kolegët që në diskutimet e tyre në këtë komision të mos sillen sikur jemi në konferenca shtypi. Unë e di edhe nga përvoja ime parlamentare që në komisionet që ka në përbërje parlamenti, kur secili prej nesh përpiqet të bëjë konferencë shtypi, gjërat e tjera mezi ecin dhe përplasemi kot së koti, duke bërë retorikë politikë.

Mendoj ta përvijojmë punën e komisionit te çështja konkrete, në këtë rast jemi te Rregullorja. Zoti Naço tha diçka për procedurë, zoti Salianji kaloi në përmbajtje, pra bëri disa komente për propozimet që ka bërë zoti Naço, ndërsa unë mendoj që të vijojmë me Rregulloren nen për nen.

Pra, ta kalojmë një herë në parim, sepse të gjithë jemi dakord që duhet të ketë një Rregullore, dhe më pas të vijojmë nen për nen.

Këto ishin ato që unë kisha.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Zoti Koçi, ju falënderoj!

Sigurisht, unë nuk kam ndër mend të orientoj se çfarë deputetët mund dhe duan të thonë. Kjo është një praktikë e gabuar, që kryetari i komisionit t'i ngucë dhe t'ua presë fjalën deputetëve për atë se çfarë ata mendojnë. Fjala është kapitali i vetëm i pacenueshëm i deputetëve. Kështu që kjo konsiderohet si një kërkesë e papranueshme nga ana ime.

Nëse secili flet si në konferencë apo si në seancë plenare, është e drejta e çdo deputeti ta bëjë këtë gjë. E para.

E dyta, rregullat për miratimin e Rregullores besoj se janë të qarta, miratimi në parim, nen për nen dhe më pas në tërësi. Kështu që propozimi juaj për ta lënë diskutimin në parim më duket jo në përputhje me Rregulloren.

Rregullorja e Kuvendit në bazë të ligjit “Për komisionet hetimore”, është e detyruar për t’u zbatuar dhe këtë nuk mund ta vendosim në diskutim.

Lidhur me atë që ju thatë për zotin Naço dhe zotin Salianji, ju kujtoj që ne kemi rënë dakord në mbledhjen e parë, mandatuam për këtë qëllim dy deputetë të nderuar që të binin dakord për ndryshime eventuale të dakordësuara mbi draftin e Rregullores që u kam sjellë. Me sa po shoh nuk ka një dakordësi të tillë, kaq e thjeshtë është.

Zoti Salianji.

Blerina Gjylameti – E morët ju fjalën kryetar, e harxhuat kohën...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Ervin Salianji – Kështu e ka ligji.

Në mënyrë që të kuptohet kërkesa procedurale, dua t’ju them, duke qenë se nuk kemi dakordësi, siç e kërkuam në mbledhjen e parë, do të diskutojmë dhe do të hedhim në votim draft-rregulloren e propozuar nga kryetari i komisionit, sepse nuk ka një Rregullore apo një dakordësi tjetër. Këtu qëndron e gjithë kërkesa procedurale për të vazhduar më tej. Ne...

Enkelejd Alibeaj – Zonja Gjylameti, ju lutem mos ndërhyni!

Ervin Salianji - ...nuk mundemi të pranojmë të kufizohen të drejtat që na janë dhënë me ligj dhe përpjekjet që të kufizohet e drejta e opozitës dhe e publikut, në këtë rast, për një çështje shumë të rëndësishme duke e shtyrë komisionin pa afat.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Salianji!

Zoti Gogu.

Toni Gogu – Zoti kryetar,

Në cilësinë e zëvendëskryetarit, në zbatim të ligjit “Për komisionet hetimore”, në të cilin thuhet që ne e drejtojmë së bashku, ju dhe unë, këtë komision, detyrohem, për shkak se ju vazhdoni të uzurponi të drejtën e komisionit për të vendosur rendin e ditës dhe ecurinë e kësaj mbledhjeje, po ashtu, në mënyrë të njëanshme po shpërndani kohën në mënyrë të tillë, ku ne kemi humbur gati 30 minuta nga propozimi i bërë nga zëvendëskryetari i këtij komisioni, anëtar i Grupit të Partisë Socialiste në këtë komision, të hedh në votim Rregulloren. Ne duam 1 orë e më parë t’i hapim rrugë hetimit, por është e qartë dukshëm që ju dukshëm doni të mbani diskutime të gjatë dhe nuk arrij ta kuptoj pse. Kemi propozuar të

hidhet Rregullorja në votim, ndërsa ju vazhdoni të mos hidhni në votim propozimet tona dhe të vendosni tërësisht ju.

Pra, nëse kjo është mbledhja e parë, mbledhjen ne e thërrasim bashkë, kështu e thotë ligji, por përsëri ju nuk e bëni këtë gjë.

Gjatë mbledhjes, në mënyrë flagrante, ju e shpërndani kohën dukshëm në favorin tuaj. Zoti Naço i përgjigjet drejtpërsëdrejti pyetjes suaj në lidhje me dakordësinë, ndërkohë që zoti Salianji luan rolin e relatorit të Rregullores që paskeni propozuar ju, e cila në një rend dite të pamiratuar paska qenë edhe dokumenti kryesor.

Kryetar, ju ftoj, pa humbur kohë, të zbatoni ligjin dhe të hidhni në votim propozimin për miratimin në parim të rregullores. Qytetarët po presin hetimin e zgjedhjeve, që ju po i bëni pis pa nisur hetimi.

Enkelejd Alibeaj – Ne, pala jonë, kemi të gjithë vullnetin dhe do ta bëjmë hetimin e zgjedhjeve. Jemi ne kërkuesit. Kjo nuk do të thotë që ne, unë, të mos respektojmë, pra unë të mos respektoj Rregulloren e Kuvendit për mënyrën si zhvillohet mbledhja. Sa herë që do të kërkohet fjala nga secili deputet, ai do ta marrë atë, është e drejta dhe përgjegjësia e tij për ato që do të thotë. Nuk kam ndër mend t'i heq apo t'i kufizoj të drejtën e fjalës askujt. Nuk kam për ta bërë këtë. Rregullorja nuk ma jep këtë të drejtë. Kërkuat fjalën, jua dhashë. Kohën e kemi, vullnetin e kemi. Kush e do fjalën?

Zoti Bardhi, keni fjalën. Gjithashtu, më pas e kanë kërkuar fjalën zoti Bylykbashi, zoti Vasili dhe zoti Kollçaku.

Gazment Bardhi – Së pari, të mos vazhdojmë më me këtë historinë e rendit të ditës, se është e qartë e gjithë gjëja, në seancë plenare miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit, sepse na u tha këtu që të lexojmë Rregulloren, lexojeni ju Rregulloren. Pra, Kryetarja e Kuvendit nxjerr urdhër për caktimin e rendit të ditës të seancës plenare. Sikundër në fund të çdo mbledhjeje, pa pyetur askënd, Kryetarja e Kuvendit njofton seancën pasardhëse. Për çfarë po flisni tani? Keni 30 minuta që keni marrë peng mbledhjen e komisionit dhe kërkoni të hidhni në votim rendin e ditës. Rendi i ditës është caktuar nga kryetari, jeni njoftuar, secili prej nesh ka të drejtën t'i kërkojë kryetarit të fusë një çështje në rend dite dhe kjo çështje është e zgjidhur. Kjo ishte për kërkesën e parë.

Sa i përket kërkesës së dytë, ajo është procedurë krejt normale, kemi caktuar dy relatorë, zotin Naço dhe zotin Salianji. A kemi ne të drejtë të informohemi si anëtarë të komisionit se çfarë produkti të përbashkët na kanë sjellë anëtarët? Zoti Naço bëri parashtrimin e tij, zoti Salianji shpjegoi arsytet pse nuk ka dhënë dakordësi për propozimet e ardhura nga zoti Naço. Ku është këtu shpërdorimi i kohës nga kryetari? Kjo është një

procedurë normale, u sqaruar, tani sigurisht do të hapim procesin e diskutimeve në parim. Nuk na caktoni ju hedhjen në votim. Kështu e bën zonja Bushka te Komisioni i Ligjeve, e voton një herë në parim, pastaj hap diskutimet në parim, në kundërshtim me Rregulloren. Zoti kryetar, po respekton Rregulloren, diskutohet në parim, pastaj hidhet në votim në parim, sepse nuk mund të votojmë një herë në parim, pastaj të fillojmë diskutimin. Këtë e bën zonja Bushka në Komisionin e Ligjeve dhe është në shkelje të Rregullores.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke bërë zonja Klotilda, e ke bërë, e kam kundërshtuar, e ke edhe në procesverbal.

Kjo është procedura parlamentare. Vazhdojmë diskutimet në parim. Opinionit publik duhet t'i thoni se me këto propozime që keni sjellë doni të merrni peng punën e këtij komisioni; të na diktoni ne se kë të thërrasim dëshmitarë, e vendosni ju me votë shumice; të na diktoni ju se çfarë të dhënash do të kërkojmë, ndërkohë që ky komision është ngritur me kërkesë të pakicës parlamentare. Hetimi parlamentar është e drejtë kushtetuese e pakicës parlamentare, e pavarur fare nga vullneti juaj. Tani, nëse ju doni që me forcën e kartonit të na diktoni vullnetin tuaj se kë do të thërrasim ne për të pyetur. E di unë e keni merakun se në planin paraprak të hetimit nga kryetari është caktuar se do të thirret ky dëshmitar dhe do të thirret edhe kryetari i Partisë Socialiste, Kryeministri Edi Rama. Do të thirret ai, pavarësisht dëshirës suaj, doni apo nuk doni ju. Kjo nuk i nënshtrohet votimit, sepse kështu thotë ligji. Nëse doni të hidhni në erë ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, na e thoni, sepse ne nuk mund të bashkëjetojmë në një sallë. Ne jemi këtu në zbatim të së drejtës sonë për një hetim parlamentar; ju jeni këtu, sepse ju ka caktuar partia për të mbrojtur vjedhjen e zgjedhjeve, ndajmë qëndrime të ndryshme, por punën do ta çojmë përpara. Ju hetoni çfarë të doni, ne do të hetojmë çfarë mendojmë se duhet hetuar. As ne nuk ju diktojmë dot se çfarë doni ju të hetoni, as ju nuk na diktoni dot se çfarë duam të hetojmë. Hiqeni idenë se çdo gjë në këtë komision bëhet me forcën e kartonit. Nuk bëhet çdo gjë me forcë kartoni, se cilat janë vendimet e ndërmjetme e përcakton ligji. Nuk shpikim ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam lexuar. Vendim i ndërmjetëm është miratimi planit të hetimit, por kërkesa për marrje provash, përfshirë thirrjen si dëshmitar, është e drejtë e çdo anëtari të komisionit dhe pranohet nga komisioni pa votim, thotë ligji. Tani ju thoni që pa votim e thotë ligji, por ne do ta bëjmë me votim se, meqenëse jeni shumicë e caktoni ju se kë do të thërrisni ju për të dëshmuar dhe kë do të hetoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po si e thoni? Prandaj, ju lutem shumë, ka një praktikë shumë të qartë parlamentare, nuk është komisioni i parë hetimor që ngrihet nga Kuvendi, keni qenë ju në opozitë, ne në shumicë, ne opozitë, ju në shumicë, kemi rënë dakord për miratimin e rregullave, nuk kemi shpikur rregulla në kundërshtim me ligjin. E kuptoj që ky komision trajton një temë sensitive, të prekshme për ju, por traditën parlamentare, eksperiencën ndër vite të fituar nga Kuvendi duhet ta respektojmë dhe të mos shpikim procedurë pas procedure për të penguar punën e këtij komisioni.

Prandaj, zoti kryetar, për të mos vazhduar më, sepse kemi 45 dhe nuk kemi hyrë ende në thelb, të vazhdojmë me diskutimet në parim për rregulloren dhe pastaj kalojmë në votimin e rregullores që ju keni propozuar.

Toni Gogu- Zoti kryetar, kërkoj fjalën.

Enkelejd Alibeaj - Ia dhashë fjalën zotit Bylykbashi, pastaj zotit Vasili, zoti Kollçaku dhe pastaj do ta merrni ju.

Toni Gogu – E kërkoj fjalën në cilësinë e zëvendëskryetarit.

Enkelejd Alibeaj - Zoti Bylykbashi keni fjalën.

Oerd Bylykbashi – Ndoshta duhet të qartësojmë pak idetë se për çfarë është ky ligj që kemi, që na bën të punojmë së bashku në komision.

Së pari, ky nuk është një komision bipartizan. Komisionet bipartizane janë të qarta, janë përdorur vetëm për reformën zgjedhore dhe janë më bashkëkryetar. Ky nuk është i tillë, ky drejtohet nga ajo forcë, që ka kërkuar hetimin parlamentar. E kemi kërkuar ne, e drejton zoti Alibeaj. Ai është kryetari, ai përcakton mbarëvajtjen e mbledhjes së komisionit.

Në lidhje me ligjin e vitit 2002 (i vetmi këtu që ka qenë deputet në atë kohë ka qenë zoti Koçi), po ju qartësoj diçka. Në vitin 2002 ky ligj është hartuar për të rregulluar hetimin e zgjedhjeve të vitit 2001. Ky ligj është bërë për atë, nuk kishte ligj deri në atë kohë dhe kur opozita, Partia Demokratike kërkoi hetimin e zgjedhjeve, nxitua dhe bëtë këtë ligj, sepse ishit në maxhorancë. Donit të bënit diçka shumë më bllokuese, por Komisioni i Venecias nuk ju la në atë vit. Po e them edhe për ju që nuk keni qenë në atë kohë.

Nëse ka një arritje të ky ligj, me të gjitha përpjekjet për ta bllokuar, është fakti që provat kur kërkohen të merren nga anëtarët, nuk merren me votim, por kërkohen dhe merren. Ky ka qenë çelësi i suksesit. Të gjitha përpjekjet që janë bërë më pas, janë bërë për t'i mbytur komisionet hetimore. Po e përsëris, ky ligj është bërë në mënyrë të posaçme për të hetuar zgjedhjet, më pas çështjet e tjera.

Praktika që vendosi ky ligj për marrjen e provave për hetimin e zgjedhjeve pa u penguar sot, duke u nisur nga ky ligj, është e konsoliduar për hetimin administrativ të

zgjedhjeve në KQZ, sepse garanton maksimumin e transparencës. Më pas le të vendosë maxhoranca, le të dalë edhe me raport e të thotë se ne nuk e njohim vjedhjen e zgjedhjeve, se ne i vodhëm, por nuk quhemi hajdutë, nëse do të arrini tek ky konkluzion, por provën nuk ia merrni dot askujt, sepse ne do ta kërkojmë dhe ajo do të merret.

Hapini të gjitha rregulloret e komisioneve kur ka pasur....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini ta mbaroj, zoti Koçi!

Ka jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka përcaktuar qartë, përkundër tentativave tuaja në legjislaturën 2013-2017 për të bllokuar komisionet hetimore, që i ka dhënë në mënyrë fare të qartë të drejtën pakicës të ngrejë komisione hetimore. Ligji, për aq sa mundet, nuk lejon vendosje pengesash. Ju po kërkon që me rregullore të ndryshoni ligjin. Kjo është absurde, por edhe e papranueshme. E thashë, kjo është praktikë e konsoliduar pikërisht për hetimin e zgjedhjeve dhe ju këtë nuk mund ta rrëzoni, jo vetëm kaq, por pikërisht prej tentativave që keni pasur për të bllokuar komisionet hetimore në gjithë këto vite, për këtë arsye ka një marrëveshje të dhjetorit 2014, ka qenë edhe zoti Vasili, dhe e kemi bashkëfirmosur atë marrëveshje, ku në një nga pikat thuhet: “Mospengimi i ngritjes dhe funksionimit të komisioneve hetimore”. E gjithë përpjekja juaj është për ta bllokuar këtë.

Merrini të gjitha rregulloret dhe do të shihni se këto që kërkon nuk ekzistojnë nuk ekzistojnë në asnjë prej tyre, as kur kemi qenë ne në maxhorancë, as kur keni qenë ju. Pse? Sepse jo vetëm qëllimi, por edhe ligji nuk e lejon këtë që kërkon ju. Është e qartë që e vetmja arsye është se me një rregull procedural, me rregullore, jo me ligj, në kundërshtim me ligjin, kërkon të bllokoni marrjen e provave. Më pas votoni kundër provës ,që është e qartë si drita e diellit, nuk ka problem, në fund, por jo për ta bllokuar marrjen. Çdo rregull procedural që ka ligji dhe rregullorja, nëse e ka, është për të ndihmuar marrjen e provave dhe për të dalë në konkluzion, jo për të penguar. Të pengoj të marrësh provën, dhe pastaj them: “Votoj se nuk ka prova!”, sigurisht kur e bllokoni, por kjo nuk mundet, se ligji nuk e lejon.

Për ta përmbyllur, harrojeni se në këtë komision do të vendoset precedenti që me votim, me maxhorancë ju të ndryshoni ligjin. Ligjin e ka miratuar parlamenti i Shqipërisë në vitin 2002, ka kaluar testin kushtetues, garanton transparencën, nëse keni siklet për këtë hetim parlamentar, edhe në vitin 2005 nuk ka qenë ky rregull që kërkon ju, kur është bërë hetimi për zgjedhjet e vitit 2005. Provat janë marrë të gjitha të lira, të papenguara. Pra, nuk mundet që ky komision të marrë përsipër barrën absurde dhe të papranueshme që me votimin e tij të ndryshojë një ligj që e ka miratuar parlamenti.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Zoti Vasili, fjala për ju.

Petrit Vasili – Kam një ndërhyrje shumë të shkurtër. Meqenëse këtu pretendohet për të mos bërë politikë, por në fakt bëhet politikë më shumë nga ç’i takon përmbajtjes. Në qoftë se do t’i referohemi vetëm ligjit, do të bëj 2-3 referenca ligjore, jo për palën tjetër, pasi është shumë e qartë që është një rol i caktuar, një obstruksionizëm i caktuar dhe nuk është se ka një surprizë, por për njerëzit që na ndjekin, të cilët duan të dinë se çfarë thotë ligji.

U pretendua për bashkëdrejtim të komisionit, por një gjë e tillë nuk mund të ndodhë, pasi neni 12 e shpreh qartë: “Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga kryetari i komisionit”. Pika 1 është shteruese: “Vetëm mbledhja e parë thirret me bashkëdakordësinë e kryetarit ose nënkryetarit”. Ligji e ka të përcaktuara qartë. Në qoftë se duam të bëjmë interpretime të tjera, le të mblidhen, se shumicë kanë, të ndërtojnë një ligj për komisionet hetimore nga e para, do të jetë në një kohë tjetër kjo, por ky ligj që kemi këtë thotë.

Ecim më tej, sërish t’i referohemi ligjit e të mos merremi me fjalë. Neni 13 e ka vrarë edhe idenë e përdorimit të maxhorancës. Pse? Që t’i japë mundësi dhe hapësirë hetimit që edhe opozitës, kur kërkon diçka, t’i mundësohet pa asnjë kufizim roli kontrollues. Unë e di që roli kontrollues bezdis, nuk pëlqehet dhe nuk e duan, por ligji ka qenë më mendjehapur dhe ka bërë këtë. Për vendimet në pikën 2 të nenit 13 thuhet në mënyrë të prerë: “Vendimet përfundimtare merren me shumicën e të gjithë anëtarëve”. Pra, këtë dënglën, më falni për shprehjen, që “jemi dhe hajt ta votojmë sa më parë se kemi 8 dhe mundim 7” ligji e ka vrarë, nuk e ka lënë. Këto vendime merren me shumicën e të gjithë anëtarëve.

E fundit, prapë për ta vrarë këtë punë, në qoftë se do t’i referohemi këtij ligji, sepse në mos i referohemi këtij ligj, nuk kemi pse të rrimë këtu, në pikën 4 të nenit 13 thuhet: “Kërkesa për hetime ose marrje provash nga çdo anëtar i komisionit pranohet nga komisioni pa votim”. Këtu mbaroi çështja, vdiq. Çfarë do të shpikim? Se kuptoj pse e vazhdojmë këtë histori!

Sa u takon atyre që ezauruan zoti Bardhi dhe zoti Bylykbashi, që të diskutojmë në parim, pasi votuar në parim, kjo është në kufijtë e idiotësisë, një çështje diskutohet dhe pastaj votohet. Kjo është praktikë 30-vjeçare e këtij parlamenti, jetë e mot ka mbaruar debati, është bërë votimi në parim dhe më pas është hapur diskutimi nen për nen. Kush e ka frekuentuar këtë parlament prej kohësh e di, por edhe të rinjtë kanë ligjin para dhe mund ta shohin. Situata është shumë e qartë, hapim diskutimin për çështjen në parim, e shterojmë në parim, pasi ta mbarojmë, e votojmë në parim, më tej e votojmë nen për nen dhe aty shikojmë ky janë ndarjet, ku janë diskutimet do të shtrëngohemi të gjejmë dakordësinë, sepse vendimi, edhe

për ta miratuar nen për nen, janë vendime përfundimtare, për të cilat, duam, nuk duam, duhet të merremi vesh të gjithë bashkë, se kështu thotë ligji. Në të kundërt, do të thotë që ka obstrukcionizëm, që nisma të mos shkojë përpara. Kaq e thjeshtë është.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Sipas radhës, fjalën e ka zoti Kollçaku, pastaj zoti Gogu.

Bardhyl Kollçaku – Ia kaloj radhën zotit Gogu.

Enkelejd Alibeaj – Dakord. Zoti Gogu.

Toni Gogu – Zoti kryetar, ju rikujtoj që mbarëvajtja e mbledhjes nuk po sigurohet nga drejtimi juaj, dhe e them këtë gjë për shkak se për njërën anë të komisionit qenka çelur diskutimi në parim i rregullores, i padeklaruar nga ju, pra zoti Bardhi, zoti Bylykbashi, zoti Vasili kanë filluar dhe po bëjnë diskutimin në parim pas një diskutimi dhe një relatimi të gjatë, sepse po diskutojnë për nene përkatëse të...

(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)

A mundet të siguroni që unë të...

Petrit Vasili – Jo, more, jo, nuk ka çfarë të sigurojë fare ai...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Toni Gogu – Jo, nuk kam mbaruar ende!

Të lutem, më lejoni që unë të mund të flas dhe të dëgjohem nga kolegët. *(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)*

Enkelejd Alibeaj – Zoti Vasili.

Toni Gogu – E dyta...

(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Absolutisht, ta lëmë të flasë çfarë ka për të thënë.

(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)

Toni Gogu – E dyta, dukshëm minutazhi që ju po vini në dispozicion, është një minutazh i cili u shërben akuzave, madje fyerjeve, etiketimeve, si: idiotësi, dëngla, bllokues dhe gjuha trupore, që e miraton këtë gjë, përkundrajt anëtarëve tanë.

Kemi zgjedhur të heshtim dhe të mos biem pre e kësaj strategjie, sepse duam ta çelim një orë e më parë hetimin. Nuk duam që t'u përgjigjemi diskutimeve politike. Kemi ardhur këtu të kryejmë detyrën tonë si parlamentarë, të hetojmë, dhe për këtë duam një orë e më parë të miratojmë rregullat e brendshme. Nëse do ta çelni diskutimin në parim të rregullores, ju lutem, deklarojeni këtë gjë që ne të mund ta fillojmë, e para.

E dyta, nëse keni vendosur që të caktoni *de facto* një zëvendëskryetar tjetër, i cili, kur bëhet një kërkesë procedurale nga zëvendëskryetari, në zbatim të nenit 10 të Rregullores:

“Kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit drejtojnë të gjithë veprimtarinë në përputhje me këtë ligj”... Ju lutem, nëse ju keni vendosur që ta caktoni *de facto* zëvendëskryetarin, i cili u përgjigjet kërkesave procedurale të zëvendëskryetarit *de jure*, duke shkelur ligjin, duke shkelur Rregulloren, ju kujtoj për të dytën herë, se jemi duke pritur, ka 45 minuta, të miratojmë në parim rregulloren.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

(Deputeti Vasili ndërhyr pa mikrofon.)

Koleg, ju lutem!

Unë e thashë disa herë që do t'i jap të drejtën të flasë kujtdo nga deputetët dhe pa i ndërhyrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kuptoj, domethënë, që unë kam kështu atakime si nga e majta, si nga e djathta, dhe është pozicion shumë komod, me thënë të drejtën, por kam një mburojë të madhe. Cila është? Ligji dhe Rregullorja e Kuvendit, të cilën do ta zbatoj deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I nderuar kolegë, ju kujtoj që ju e keni marrë fjalën më shumë se kushdo tjetër nga kolegët e tjerë, sigurisht, për hir të faktit se jeni zëvendëskryetar. Unë e kam pasur parasysh këtë gjë, por kjo nuk do të thotë që të gjithë kolegëve, që flasin dhe kërkojnë për të folur, të mos ua jap këtë fjalë, e para.

Që të jemi të qartë, nuk konstatova asnjë tendencë në artikulum nga asnjë nga kolegët, as majtas, as djathtas deri tani, as për të fyer, as për të tallur; as me fjalë dhe as me gjeste trupore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tendenca që po bën tani për të më ndërprerë fjalën, nuk të shkon pikërisht në shkeljes të Rregullores.

Toni Gogu – Kam pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Jo, të mbaroj, se po flas unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flas unë tani, të lutem!

Kështu që për këtë arsye po sqaroj edhe diçka tjetër.

Lidhur me kërkesën tuaj për diskutimin në parim, po, do të diskutohet në parim, por, para se të diskutohej në parim, do të diskutonim për punën e përbashkët që zotërinjtë Naço dhe Salianji duhej të kishin bërë.

Në mbledhjen e parë ramë dakord me propozimin tuaj, të zonjës Bushka, sipas traditës së mbledhjeve të mëparshme të komisioneve hetimore që dy përfaqësues bien dakord për të nxjerrë amendamente të dakordësuara për draftin që kryetari ka depozituar. Ju do të thoni që të mos informohen kolegët e tjerë?! Kjo nuk do të ishte e mbarë dhe e gjithë kjo procedurë e fjalës që morët ju dhe kolegët e tjerë, i ezauroi të dyja çështjet: informimin dhe faktin tjetër më të rëndësishëm që nuk ka një dakordësi; kaq e thjeshtë. Secili prej anëtarëve do të duhet ta dijë këtë. Nuk ka një dakordësi, gjë e cila do të thotë që nuk ka asnjë lloj amendamenti tjetër të sjellë zyrtarisht për këtë draft që unë e kam sjellë në detyrim të ligjit; kaq e thjeshtë është.

Për këtë arsye, tashmë më duhet të sqaroj edhe diçka tjetër të rëndësishme. Sipas relatimit të bërë nga zoti Salianji dhe kolegët e tjerë, ato se çfarë janë diskutuar, por për të cilat nuk ka dakordësi, janë të thjeshta. Nëpërmjet këtyre propozimeve kërkohet që vetëm dy të drejta thelbësore, që i përkasin pakicës parlamentare, e cila ka kërkuar ngritjen e komisionit hetimor, dhe që janë të mishëruara në ligjin “Për komisionet hetimore”, të përmbysen. Cilat janë këto të drejta?! E para është drejtimi i komisionit, që në ligjin “Për komisionet hetimore” është e përcaktuar fare qartë që kryesimin e komisionit hetimor e ka ai grup parlamentar, ajo pjesë e parlamentit, që e ka kërkuar komisionin hetimor dhe, si balancë e kësaj, pjesa tjetër ka shumicën. Ju doni që me një të drejtë, që ta jep Kushtetuta, ta jep ligji “Për komisionet hetimore”, ta përmbysni me rregullore dhe të thoni se drejtimi nuk bëhet nga kryetari, por doni të fusni këtu edhe zëvendëskryetarin, edhe sekretarin, është fare e thjeshtë logjika. Nënkryetari dhe sekretari, që më gjasa i takojnë atyre që kanë shumicën, të asfiksojnë të drejtën ligjore që ka kryetari, kjo është e papranueshme në aspektin logjik, por mbi të gjitha në aspektin ligjor. Po ju them këtë gjë: kjo është në fakt tentativë e turpshme, të tentohet që ligji të përmbushet me Rregullore. Unë nuk kam për ta bërë kurrë këtë gjë, me aq të drejta që Rregulloja e Kuvendit, ligji për komisionet më japin. Iniciativa, propozime, të cilat bien ndesh me ligjin, nuk kam për t’i hedhur në votim, sepse unë nuk dua ta shkel ligjin dhe s’do ta shkel ligjin. Kjo është e para.

E dyta, që është më rëndësishmja, ju kërkonin që një nga të drejtat thelbësore të komisioneve hetimore të opozitës, të çdo anëtari të komisionit, pra e drejta për të kërkuar prova, që sipas ligjit është e pakufizuar, nuk i nënshtrohet votimit, t’ia nënshtrohet votimit. Aritmetika është e thjeshtë. Ne e dimë që ju keni shumicën. Pra, çdo kërkesë që mund të

bëjë cilido deputet këtu, për të thirrur Kryeministrin, për të thirrur ministrat, për të thirrur drejtues institucionesh, për të marrë dokumente, juve doni t'ia nënshtroni votës, që do të thotë mund të mos ia pranoni, ndërkohë që ligji e thotë fare qartë në nenin 14: “Kërkesa pranohet pa votim”. Pra, bëni një propozim që kapërcen ligjin, në kundërshtim me ligjin. Më ftoni mua të hedh në votim një propozim antiligjor dhe antikushtetues. Nuk e bëj e dot edhe nëse do të doja, Për një arsye fare të thjeshtë, nuk dua ta shkel ligjin. Nuk dua ta shkel ligjin dhe s’do ta shkel ligjin.

Së treti, ajo ç’ka është e rëndësishme, kolegë, ramë dakord në mbledhjen e kaluar që propozime alternative do të vinin të dakordësuara prej 2 kolegëve tanë të nderuar, s’kanë rënë dakord për këto arsye. Ngelet i vetmi draft për t’u diskutuar në parim, për t’u diskutuar nen për nen, edhe në tërësi, sipas Rregullores së Kuvendit, ky që unë kam paraqitur dhe jam duke ia nënshtruar tashmë procedurës.

Kështu që, hap diskutimin për draftrregulloren e brendshme të komisionit hetimor “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.79/2021. Kjo draftrregullore, siç unë e bëra të qartë edhe në mbledhjen e parë, pasi kisha detyrimin për ta bërë këtë gjë, nuk është gjë tjetër, veçse draftrregullorja e përdorur sipas rregulloreve të komisioneve hetimore të mëparshme. E mbani mend? Ju u tallët mbledhjen e parë: ç’është kjo?! E pra, që të mos krijoja asnjë lloj insinuate, që po krijomë rregulla të reja, bëra një gjë fare të thjeshtë, rregulloret e komisioneve të mëparshme, që, siç me të drejtë e tha edhe zoti Bylykbashi, kanë qenë me konsensus dhe është bërë një luftë e madhe për këto ligje dhe për këto rregullore, i solla këtu. Ligji ka që në vitin 2002 që është në fuqi, rregulloret janë miratuar sa herë ka pasur komisione hetimore, edhe për zgjedhjet në këtë rast, tradita është e kalcifikuar dhe për këtë arsye unë e sjell këtë rregullore në këtë formë. Pastaj, vendimi final është e drejta e gjithsecilit. Ligji e përcakton që në raportin final secili ka votën e vet.

Të nderuar kolegë, për diskutimin parim të rregullores që është paraqitur nga kryetari i komisionit, në atë gjendje, siç ju është shpërndarë në mbledhjen e parë të këtij komisioni, kush e do fjalën?

Toni Gogu – E dua unë, zoti kryetar.

Enkelejd Aliebjaj - Zoti Gogu, pastaj zoti Bardhi.

Toni Gogu - E kam për procedurë, nuk e kam për diskutimin në parim.

Ne të dy kujdesemi për mbarëvajtjen e kësaj mbledhjeje dhe të këtij komisioni, mbledhjen pa dyshim që e drejtoni ju, por ju kujtoj për të tretën herë: mbledhjen po e

drejtoni në kundërshtim me ligjin për komisionet e posaçme dhe në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, sepse roli juaj është që të siguroni, të çelni pikat e diskutimi, të ndiqni rendin e ditës. Ajo çfarë unë kërkoj tani, për shkak se një grup i tërë, një pjesë e madhe e anëtarë të komisionit tonë kanë bërë tashmë një komision në parim, sepse me sa duket kuptuan që diskutimi në parim ishte çelur për ta dhe nuk ishte çelur për ne, ne jemi gati, jo se nuk kemi argumente, sepse do t'i shpalojmë ato të gjitha, do t'i shtjellojmë, sesi gjëja që ne po kërkojmë është vetëm në zbatim ligjit dhe vetëm në zbatim të Rregullores së Kuvendit, ajo çfarë po kërkojmë është që të mos humbim kohë me diskutime politike. Është shumë e dukshme, keni marrë gati një orë kohë për të bërë një gjyq pa nisur hetimi, duke na akuzuar. Ju lutem, sigurohuni që ne të vazhdojmë proceduralisht. Kërkesa tjetër që kam, a mundet që ju t'u lini më shumë kohë, për shkak se keni rolin e kryetarit dhe keni edhe mikrofonin, kolegëve tuaj, të parashtrajnë dhe ju të kujdesin më shumë që drejtimi i mbledhjes të jetë, të duket, të paktën i paanshëm.

Faleminderit!

Enkelejd Aliebaj - Për sa kohë që pata atakime si nga e majta, si nga e djathta, më të paanshme se kjo nuk ka.

Kam çelur diskutimin në parim, ia dhashë fjalën zoti Gogu, tha ç'kishte për të thënë, zoti Bardhi diskutim në parim për rregulloren që ju kam paraqitur.

Faleminderit!

Gazmend Bardhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Vetëm një parantezë të shkurtër, askush në këtë komision nuk na dikton dot se çfarë do të flasim, kështu që, të lutem, zoti zëvendëskryetar, mos e përsërit më se e ke thënë 3 herë sot në mbledhje, se çfarë do të duhet të flasim ne. Të na diktosh ne sesi flasim! Ne nuk kemi bërë asnjë diskutim në parim, kemi thënë atë që ne gjykojmë në varësi të çështjeve procedurale që janë shtruar për diskutim dhe nuk presim, sikundër ne nuk u japim sugjerime, sesi ju shpreheni, edhe pse në fakt, herë pas here shpreheni gabim, sepse thatë: keni caktuar një zëvendëskryetar nga krahu tjetër. Sipas Rregullores së Kuvendit, kur ka një propozim procedural, ka një mendim pro dhe një mendim kundër, dhe këtë ka bërë kryetari. I ke thënë kryetarit 10 herë “po shkel ligjin” dhe nuk ke treguar një shkelje të ligjit. Fakti që dikush këtu nuk i di rregullat apo e di ligjin gabim, nuk do të thotë që po e shkel ligjin kryetari. Fakti që secili prej nesh merr fjalën, siç e morën të gjithë kolegët, zoti Koçi, të gjithë folën. Secili foli sipas të drejtës së vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse nuk dua ta zgjasë.

Secili tha atë që mendonte. Tani, ju e keni marrë tri herë fjalën dhe komentoni fjalët tona: nuk duhet të flisni kështu, por duhet të flisni kështu.

Kjo ishte e para, për të na lejuar të shprehim mendimet tona në mënyrë të lirë në një mbledhje komisioni, pa i diktuar njëri tjetrit çfarë të themi. Është gjëja më normale e mundshme. Sigurisht, bie dakord me thirrjen që do të duhet të shprehemi pa asnjë shkelje të etikës, pa asnjë fyerje apo epitete ndaj njëri-tjetrit, sepse nuk jemi këtu për këtë. Jemi për të kryer një hetim parlamentar.

Për t'iu kthyer Rregullores, zoti kryetar, unë kërkoj edhe mirëkuptimin e kolegëve të maxhorancës që të mos bëjmë diskutime që largojnë vullnetin e përbashkët që na duhet për miratimin e rregullores. Ka pasur diskutime me orë, në të njëjtën sallë, nga të njëjtët aktorë, për rregulloret e komisioneve hetimore. Ka një version të dakordësuar të këtyre rregulloreve, që ka fituar tashmë statusin e precedentit parlamentar dhe ne nuk mund ta shkelim këtë precedent parlamentar. Sikundër nuk mundet në asnjë rast që me rregullore të brendshme të komisionit hetimor t'i kufizohet e drejta çdo anëtari për të kryer hetime.

Prandaj, rregullorja është e thjeshtë. Ai draft që ju keni propozuar, zoti kryetar, përmban çështjet kryesore për organizimin dhe funksionimin e punës së komisionit. Sigurisht, për çështje që nuk biem dakord, nuk kemi pse t'i diktojmë njëri-tjetrit rregulla për organizimin dhe funksionimin në punën tonë. Të ecim me çështjet për të cilat biem dakord dhe të miratojmë një rregullore. Të jem i sqarë, për aq sa unë e kam ndjekur punën e komisioneve hetimore, nuk ka qenë ndonjëherë nevoja për t'iu referuar rregullores së brendshme, sepse përgjithësisht çështjet në mënyrë të përgjithshme janë trajtuar nga ligji. Sigurisht, ka edhe një praktikë parlamentare, duke qenë se sipas ligjit zbatohet edhe Rregullorja e Kuvendit, prandaj, të mos krijojmë ngërçe të kota në punën e këtij komisioni, me propozime që qartazi janë provokim ndaj opozitës.

Ne citojmë ligjin, kurse zoti Naço i vendos vizë dhe shpik një rregull të ri. Pra, ligji thotë këtë që kemi thënë edhe ne në Rregullore: “kërkesa për hetime ose marrje prove nga çdo anëtar i këtij komisioni pranohet pa votim, sipas përcaktimeve të nenit 13, pika 4 e ligjit”. Këtë zoti Naço e fshin. Pra, nuk ka rëndësi çfarë thotë ligji, ka rëndësi se çfarë propozohet nga Partia Socialiste.

Cili është propozimi? Propozimi është: “Anëtarët e komisionit kanë të drejtë t'iu kërkojnë komisionit të marrë të dhëna, informacione, dokumente zyrtare, të pyesë dëshmitarë. Komisioni shprehet me vendim të ndërmjetëm për to”. Pra, ligji thotë që kërkesa e çdo anëtari nuk i nënshtrohet votimit, kurse ju sillni si propozim që kjo do të duhet të miratohet me vendim të ndërmjetëm. Kjo është të marrësh peng, të krijosh ngërçe të kota në

punën e këtij komisioni, të na pengoni dhe të bëni të kundërtën e asaj që kryetari e përsëriti tri herë.

Duam të nisim hetimin, thotë. Si ta nisim hetimin!? Ju thoni që do të votojmë ne për çfarë doni ju të hetoni, ndërkohë që kërkuesit e këtij komisioni hetimor janë nga ky krah. Të ishte për ju, nuk e kishit ndër mend të kërkonit komision hetimor. Komisionet hetimore i kemi kërkuar ne, kurse çfarë do të hetojmë do ta vendosni ju! Kjo është të krijosh një ngërç të panevojshëm në punën e komisionit. Do të kemi ngërçe sa të duam deri në fund të këtij hetimi sepse nuk do të biem dakord për gjëra apo për çështje të ndryshme, nuk do të biem dakord ndoshta edhe për leximin apo interpretimin e provave dhe të dhënave që do të mbledhim, dhe kjo është gjëja më normale, mirëpo për rregulla që janë dakordësuar, që janë miratuar me ligj nga Kuvendi, që ka një praktikë 30-vjeçare të këtij parlamenti se si funksionojnë këto komisione, nuk kemi as pse të shpikim dhe rregulla të reja që na pengojnë në punën tonë dhe as pse të krijojmë ngërçe që, në fakt, tregojnë tmerrin e madh që keni nga rezultatet e këtij komisioni hetimor.

Nuk ka shpjegim tjetër që të na diktoni ne një gjë që nuk e ka ligji. Ligji thotë pa votim, kurse ju thoni që do ta hidhni në votim. Thotë që e vendos shumica. Si vendos shumica, në kundërshtim me ligjin? Unë e kuptoj që ju e keni praktikë shkeljen e ligjit, e keni treguar kur keni kryer detyra të caktuara shtetërore, i keni rënë me shkelm ligjit dhe Kushtetutës, por nuk jemi këtu për këtë, por për të hetuar shkeljet e ligjit në zgjedhje. Për rregullat e funksionimit të komisionit do të duhet t'i nënshtrohemi vetëm ligjit.

Prandaj, kryetar, unë propozoj atë draft që ju keni depozituar që në mbledhjen e parë (nuk ka asnjë amendament të paraqitur zyrtarisht në përputhje me Rregulloren e Kuvendit), dhe ne të vazhdojmë me votimin nën për nën të atij drafti. Sigurisht, mund të ketë propozime për çështje që nuk biem dakord, nuk miratojmë rregullin dhe zbatojmë drejtpërdrejtë ligjin.

Faleminderit!

Toni Gogu – Të lutem, kërkoj fjalën për procedurë dhe për replikë.

Enkelejd Alibeaj – E ka kërkuar fjalën zonja Gjylameti që në fillim.

Zonja Gjylameti, do ta merrni fjalën, sepse keni të drejtën? Jemi në diskutimin në parim?

Nëse nuk e merrni fjalën, nuk do ta merrni më atë.

Toni Gogu – Për procedurë, zoti kryetar.

Enkelejd Alibeaj – Të lutem! E ka fjalën zonja Blerina Gjylameti, deputete e Partisë Socialiste, anëtare e komisionit hetimor.

Zonja Gjylameti, do ta merrni fjalën?

Blerina Gjylameti – Po, do ta marr.

Enkelejd Alibeaj – Urdhëroni!

Blerina Gjylameti - Kryetar, në radhë të parë, duke qenë se jeni edhe në një rol drejtues në parlamentin shqiptar, procedurën parlamentare dhe mënyrën se si jepet fjala duhet ta dini shumë më mirë se çdokush tjetër që është këtu. Në momentin që një koleg kërkon fjalën për procedurë, e merr fjalën për procedurë, sepse pikërisht në kahun e majtë të sallës së parlamentit, përtej faktit në komisione, ju ankoheni vazhdimisht për faktin që procedura prevalon. Në rastin konkret pse nuk prevaloi për ju procedura?

Unë kam disa pyetje për ju.

Kryetar, kam idenë se gjatë gjithë kohës ju keni një problem me veten, një kompleksitet që nuk po jua kuptoj. Ka të bëjë me problemin e lidërshiptit, e drejtimit apo ka të bëjë me faktin ...?

Enkelejd Alibeaj – Ju kujtoj që në bazë të Kodit të Sjelljes, të mos përdorni terma jo të përshtatshme dhe kini parasysh që kolegëve ju drejtohet me “zoti” ose “zonja”.

Blerina Gjylameti – Ju lutem, mos më ndërprisni. Mos m’u drejtoni! Nuk ju ndërpreva.

Enkelejd, të lutem, mos më ndërhyjni! Meqenëse më drejtoheni me emër. Zoti Alibeaj, ju lutem, mos më ndërhyjni kur flas!

Enkelejd Alibeaj - Kini parasysh që zoti Gogu sapo të mbron fjalën do t’ju thotë që po përdorni terma fyese.

Blerina Gjylameti – Patjetër. Jepjani mundësinë. Herën e kaluar unë u ankova, madje edhe ju sugjerova që të ishit i paanshëm. Ndërkohë, sot, gjatë drejtimit, kuptova që kisha qenë e gabuar, sepse ju nuk kishit qenë në asnjë moment i paanshëm, madje sot e treguat gjatë gjithë kohës që për qëndrimet e Partisë Demokratike duhet t’i merreni vazhdimisht konfirmim zotit Bardhi, sikurse nuk jeni ju përfaqësues të Partisë Demokratike, së pari.

Së dyti, në anën tjetër, e kuptoj gjatë gjithë kohës që këtij komisioni, krahut përballë, i mungon foltorja dhe gjatë gjithë kohës po mundoheni ta shfrytëzoni këtë pjesë.

Dhe, kryetar...

Enkelejd Alibeaj - Është sugjerim që të flasim për diskutime në parim të rregullores, zonjë.

Blerina Gjylameti - Nuk është fyese, ju mungon foltorja. Doni kohën televizive të foltores dhe ju po e merrni. Ju keni një problem, që nuk ua zgjidhim dot ne, kryetar. Zoti Bardhi, nuk ua zgjidhim ne dot hallin që keni midis jush, se kush do ta drejtojë këtë gjë. Ju keni zgjedhur zotin Alibeaj që ta drejtojë dhe gjatë gjithë kohës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është etika që po flisni. E keni propozuar ju, si përfaqësues të Partisë Demokratike.

Enkelejd Alibeaj - Zonjë përfundoni fjalën tuaj.

Blerina Gjylameti - Të lutem, jepini mundësi që jo në çdo tri fjalë të vazhdojë dhe të thotë: “Unë si kryetar, unë si kryetar, unë si kryetar”, sepse nuk bëhesh dot kryetar duke vazhduar ta thuash këtë. Çështjet e lidershit duhet t’i zgjidhni në një vend tjetër, jo këtu.

Më lini të flas me qetësi, sepse nuk më shkon të ngre zërin, aq më shumë për faktin që përballë kam një grup njerëzish dhe kolegësh të nderuar, burra, të cilët gjatë gjithë kohës, sa herë na referoni se bëjmë gabim që flasim nga vendi, lëshohen. Kjo nuk i shkon këtij komisioni, nuk na shkon as për rolin dhe përfaqësimin që ka gjithsecili.

Enkelejd Alibeaj - Këtu keni drejtë.

Blerina Gjylameti – Gjatë gjithë kohës që ju folët unë mbajta shënime. Dëgjova zotin Bardhi për një sërë problematikash që ngriti dhe, mbi të gjitha, për shqetësimet që mund të kishim ne, si maxhorancë. Ai tha se ne jemi trembur shumë, sepse pamë planin paraprak të hetimit, por u trembëm edhe më shumë se pamë emrat! Ndërkohë, zoti Bardhi, dua t’ju kujtoj një gjë fare të thjeshtë. Zoti Rama ka qenë në këtë sallë në komisione hetimore që kur ka qenë kryetar bashkie dhe ka ardhur pa pasur nevojë, atë që tha zoti Alibeaj, që donte të merrte një *head line*, se ka probleme në parti, që ta marrin forcërisht. Nuk përbën lajm ajo që ju thatë, sepse nuk ka ndodhur ndonjëherë.

Ndërkohë, zoti Bardhi, dua t’ju kujtoj një element tjetër ju. Zoti Basha kurrë nuk ka qenë kur është thirrur, për asgjë, madje është justifikuar me disa raporte, që im bir, i cili është 13 vjeç, do t’i vinte shumë zor të justifikojë: një herë kishte probleme të barkut, një herë kishte probleme që ishte sëmurë, një herë kishte probleme që raporti....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është parimi. Çelni diskutimin në parim. Në parim, raportet që zoti Basha ka përdorur nga mjekët për të justifikuar për të mos vajtur kurrë kur është thirrur janë qesharake edhe për një fëmijë 12-vjeçar. Ndërkohë, në anën tjetër, sot e kuptova se sa ju ka shqetësuar ajo punë që ka bërë zoti Naço, sepse ekzaktësisht kemi që në orën 10:00 që vazhdojmë e diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Bardhi, të lutem, më lër të mbaroj, sepse jemi në diskutimin në parim!

Dua t’ju them edhe një element tjetër. Kjo rregullorja nuk bën asgjë ndryshe, përveçse të detajojë dhe të rregullojë mënyrën e funksionimit të këtij komisioni parlamentar. Një pjesë

e mirë e kolegëve që kam përballë kanë qenë pjesë e komisioneve hetimore dhe i dinë problematikat që kemi pasur me komisionet hetimore. Zoti Bylykbashi në një moment përmendi edhe një fakt, që ne kemi qenë bllokues për komisionet hetimore. Në vitin 2014 kemi qenë ne në maxhorancë, jo ju, dhe kemi pranuar çdo kërkesë për komision hetimor...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lër ta mbaroj. Unë po ju them që kërkesën tuaj e kemi pranuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Bardhi, unë e di që ju shqetësoj kur ju them disa gjëra që nuk ju pëlqejnë, por mua nuk më mungon koha televizive dhe nuk kam nevojë të përdor këtë foltore për kohën televizive. Shpresoj shumë që të mos ju mungonte edhe juve, por këtu po na tregoni të kundërtën.

Po ju them edhe një herë. Në parim ne duhet ta miratojmë këtë rregullore, pastaj nën për nën hajdeni ta diskutojmë se çfarë duhet të ndryshojmë, por ne kemi dy orë këtu, ose më mirë 1 orë e 25 minuta, që vazhdojmë dhe diskutojmë që ne nuk duam të shkelim ligjin, ndërkohë që ne po e shkelim.

Zoti kryetar, duhet ta hidhni në votim, sepse është ajo që keni për detyrë, por ju thatë: “Unë nuk e hedh, sepse kjo rregullore...”. Zoti kryetar, zoti Alibeaj, ju duhet ta hidhni në votim dhe më pas (shyqyr që kemi zotin Salianji, i cili na sugjeron herë pas herë, sepse çfarë do të bënim ndryshe po të mos ishte ai)....

Enkelejd Alibeaj - Mos zër emrat e kolegëve në gojë, sepse përndryshe do të kërkojnë replikë. Tregohuni e kujdesshme!

Blerina Gjylameti - Zoti Alibeaj, ju kërkova gjatë gjithë kohës që të mbani qetësi, në mënyrë që kur të flasim...Unë dëgjoj shumë mirë dhe ju na kërkuat gjatë gjithë kohës që të mos ndërhyjmë. Ne nuk ndërhyjmë. Unë mbajta shënime për çdo fjalë që thanë kolegët. Prandaj, unë them që ta hedhim në votim dhe pastaj diskutojmë atë që përcakton ligji, në mënyrë që atë që kemi merak të gjithë, që është fillimi i funksionimit të këtij komisioni, të mos e pengojmë me dëshirën për të marrë, kush një lajm këtu e kush një lajm atje, vëmendjen, që nuk merret nga këtu. Ajo vëmendje merret kur të dalim te partitë përkatëse dhe jo këtu.

Ndërkohë, dua t'ju falënderoj shumë që gjatë gjithë kohës na e vini në dukje se sa dashamirës jeni, se sa lëshime bëni, se sa të mirësjellshëm jeni dhe se çfarë është ky fat i madh që na ka ardhur, që, më në fund, kemi gjetur një njeri që na drejton dhe thotë: “Për shkak të mirësjelljes sime, për shkak të kohës sime, për shkak të dashamirësisë sime...”! Unë besoj se kryetari nuk i bën këto gjëra për shkak të dashamirësisë, sepse kjo është një

karakteristikë personale, që mund ta keni dhe mund ta vlerësojmë, por i bëni për shkak të ligjit. Prandaj, respektojeni atë ligj, duke lënë mënjane pjesën dashamirëse, sepse, siç ju ndodhi edhe më parë, do t'ju godasin edhe ata të kahut tjetër. Deri dje kishit vetëm këtë kah, por sot po ju godasin edhe ata. Prandaj, ju lutem, përqendrohuni pak më shumë te rregullorja dhe më pak te pjesa dashamirëse!

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj - Faleminderit, zonja Gjylameti!

Toni Gogu - Kryetar, e kam kërkuar fjalën përpara të gjithë kolegëve dhe kam të drejtën e replikës. Kam grumbulluar një sërë kërkesash procedurale pranë jush, a i keni evidentuar?

Enkelejd Alibeaj - Zoti Gogu, mos bëni ndërhyrje pa leje, është minimumi i respektimit të rregullores.

Toni Gogu - Po kërkoj fjalën.

Enkelejd Alibeaj - Do t'ju jap fjalën ju, do t'ju jap të gjithë kolegëve...

Toni Gogu - E kam kërkuar fjalën...

Enkelejd Alibeaj - E kuptoj fare mirë që diskutimin në parim secili e shfrytëzon siç e mendon. Zoti Bardhi dhe zonja Gjylameti e ezauruan diskutimin në parim, dashamirësi ime do të jetë gjithmonë, përveçse ligjit. Më pas, nëse ka shqetësime, qortime si këtej, si andej, i kam shpatullat e forta, pa merak për këtë punë: ligji dhe vetëm ligji në këtë rast.

Toni Gogu – Kryetar, kam kërkuar, fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Xhaferraj, keni fjalën.

Toni Gogu – Zoti Kryetar, kam kërkuar fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Gogu, jemi në diskutimin në parim. Zoti Xhaferraj ka kërkuar fjalën. Të lutem, mos u bëj shkak për ndërprerjen. Do ta marrësh fjalën pas zotit Xhaferraj, sipas radhës, një këtej dhe një andej; është e thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse radhën e përcakton kryetari dhe kryetari ka vendosur këtë rregull: rregull barazie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos e ngrini zërin, sepse kjo tregon që po të lëshojnë nervat. Rregulli është fare i thjeshtë: një andej dhe një këtej.

Zoti Xhaferraj, keni fjalën.

Ferdinant Xhaferraj – Zoti Gogu, shumë shkurt do të flas.

Toni Gogu – Zoti kryetar, kam kërkuar fjalën për procedurë.

Enkelejd Alibeaj – Do ta marrësh fjalën menjëherë pas zotit Xhaferraj.

Zoti Xhaferraj, keni fjalën.

Toni Gogu – Zoti kryetar, zoti kryetar...

Enkelejd Alibeaj – Zoti Gogu, në bazë të Rregullores, po ju vë në dijeni që jeni duke shkelur rregullat dhe duke penguar punimet e komisionit. Ju tërheq vëmendjen!

Zoti Xhaferraj, keni fjalën për diskutimin në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pas zotit Xhaferraj do ta marrë fjalën zoti Gogu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ferdinant Xhaferraj – Për procedurë jam edhe unë. Qëkur ka filluar mbledhja nuk kam folur. Ju keni folur katër herë, kurse për mua është hera e parë që po flas.

(Diskutime pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Zotërinj të nderuar, nuk e zgjidhni dot në këtë mënyrë. Rregulli që kam vendosur dhe po e zbatoj është ky: një këtej dhe një andej në kushte barazie, duke mos pasur asnjëri privilegj.

Zoti Xhaferraj, do të flisni për diskutimin në parim.

Ferdinant Xhaferraj – Unë do të flas shumë shkurt.

Së pari, meqenëse zonja Gjylameti nuk mbaroi dhe ka gjëra të tjera për të thënë, i jap nga koha ime të shprehet, sepse vërtet na shqetësoi shumë.

Enkelejd Alibeaj – Mos na ktheni mbrapa. Secili ka të drejtën e tij, se këtu po të ndërhyj unë, nuk ta jap të drejtën t'i japësh nga koha juaj askujt tjetër. Koha jote është jotja.

Ferdinant Xhaferraj – Dua t'i them zotit Gogu që me shumë etikë disa herë kërkoi, dhe ishte shumë i shqetësuar, që po humbasim kohë për ta çelur sa më parë hetimin. E tha disa herë dhe këtë po e them në kuotë...

Të lutem, shumë zoti Gogu, sepse jeni zëvendëskryetar i këtij komisioni, këto ditë janë vonuar krejtësisht për shkakun tuaj. Dhe pse?! Që në mbledhjen e parë të komisionit ramë dakord, dhe ishte futur në rendin e ditës, miratimi i rregullores. Hapët debatin në mbledhjen e parë dhe bëtë oponencë për rregulloren, duke parashtruar jo më probleme thelbësore të rregullores, por thjesht ndërhyri zoti Naço që donte disa korrektive, përditësime dhe problemet ishin shumë sekondare. Ka kaluar pothuajse një javë, dhe jemi përsëri te rregullorja, krejtësisht për shkakun tuaj dhe arsyeja tani ka dalë fare zbuluar: ju doni t'i çelni sa më parë hetimet, por doni t'i çelni me çelësa që i kontrolloni ju. Kjo punë nuk mund të bëhet kështu.

Ju lutem (kam drejtuar nja dy komisione hetimore, ka marrë pjesë në 5-6 të tilla), nuk mund të shkohet deri këtu! Singërisht, përcillni shijen që keni një frikë shumë të madhe, se shumë gjëra i dimë ne, por ju mund të dini shumë më tepër se ne se çfarë ka ndodhur në ato zgjedhje. Si mundet të kërkoni... Kemi nenin 13, e ka zgjidhur ligjvënësin në vitin 2002, që në pikën 4 përcakton shumë qartë: “Kërkesa për hetim ose marrje provash nga çdo anëtar komisioni pranohet pa votim”. Te pika 2 e nenit 13 ka futur se cila është kompetencë e vendimit të ndërmjetëm. Si të doni... E ka zhveshur, pra te pika 4 e ka hequr hetimin dhe marrjen e provave nga e drejta e vendimit të ndërmjetëm. Pra, ju kërkoni t’i çelni hetimet sa më shpejt, por me çelësa hetimesh që i kontrolloni ju, dhe kjo nuk bëhet. Jeni katërçipërisht në kundërshtim me ligjin dhe arsyeja që jemi vonuar një javë, ka qenë se donit të ndërhyni në rregullore pikërisht për këtë nen.

Ju lutem, është mirë që disa gjëra t’i themi hapur, ashtu sikurse qëndrojnë. Nuk e shmangni dot: e gjithë fryma e hartimit të këtij ligji drejtohet nga opozita për të bërë hetimin. Nuk është komision bipartizan dhe hetimin nuk mund ta shmangni dot. Se çfarë kompetenca keni ju për vendimet përfundimtare me shumicën e votave e të gjitha, jua jep ligji, por në këtë pikë ligji është bardhë e zi në favorin tonë.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Zoti Gogu, keni fjalën për diskutimin në parim.

Toni Gogu – Zoti kryetar, po e filloj, së pari, për procedurë, përsëri për herë të dytë, madje për procedurë mund të jetë hera e katërt, për shkak se mbarëvajtja e mbledhjes është duke shkuar keq e më keq për shkak të drejtimit tuaj. Pse?! Kemi dhënë pëlqimin, pra diskutimi ynë, si grup, në parim ka qenë që jemi plotësisht dakord me rregulloren që keni paraqitur ju dhe duam ta votojmë atë në parim, e kemi thënë para dy orësh këtë gjë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Zoti kryetar, a mund të vendosni rregullin?

Enkelejd Alibeaj – Po.

Toni Gogu – Zoti Bardhi, më zuri emrin...

Enkelejd Alibeaj – Ju lutem, mos u drejtoni kolegëve me emër, sepse u jep të drejtën dhe gjithsecili ka drejtën të bëjë replikë, të paktën këtu tregohuni më të kufizuar.

Toni Gogu – Atë të drejtë që ju sapo ma mohuat.

Zoti Bardhi tha që unë kam përmendur ligjin, por nuk e kam cituar atë. E kuptoj zotin Bardhi, si proceduralist kërkon që unë të citoj. Prezumova që zoti Bardhi e njeh shumë mirë ligjin, i cili në nenin 11 thotë: “Mbledhja e parë e komisionit thirret nga kryetari dhe zëvendëskryetari”, gjë që ju e keni shkelur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Zoti Bardhi, të lutem, lëreni të shprehet deri në fund! **Toni Gogu** – Keni krijuar këtë vonesë që jemi sot këtu. Përpara dy orësh kemi dhënë pëlqimin për rregulloren që keni paraqitur ju, ndërkohë që ju u keni dhënë, u keni çelur në fshehtësi diskutimin për nenin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti kryetar, mos ndërprisni. Zoti kryetar, keni monopolizuar drejtimin e mbledhjes në një mënyrë flagrante. Atëherë, keni shkuar dhe po bëni diskutimin e nenit 13, ndërkohë që diskutimi në parim i rregullores suaj... Pra, unë nuk e di, ne po diskutojmë rregulloren që keni paraqitur ju. Kolegët janë duke na akuzuar dhe janë duke bërë atë punë që keni bërë për gjithë këtë kohë, duke na paragjykuar, duke na fyer, duke na ofenduar mbi disa propozime që ne kemi çuar për t'i diskutuar, kur të vijë neni përkatës. Pra, ju, në mënyrën se si keni drejtuar mbledhjen sot, keni humbur 2 orë ose 2 orë jua keni hequr shqiptarëve, të cilët duhen të shikojnë se si hetojmë ne dhe duhet të përmbushim detyrën tonë si parlamentarë. Jua keni dhënë kolegëve tuaj të bëjnë diskutime politike mbi një nen të caktuar të Rregullores që ne duhet të diskutojmë kur të shkojmë te diskutimi nen për nen.

Ndaj, edhe një herë ju ftoj, në emër të gjithë grupit socialist, ne kemi dhënë pëlqimin e Rregullores, që ju keni paraqitur në parim dhe propozojmë, përsërisim propozimin tonë, i cili nuk është hedhur në votim (ka 2 orë që nuk është hedhur në votim), në kundërshtim me ligjin dhe me Rregulloren, që të votohet në parim rregullorja.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Gogu!

Propozimi juaj është marrë parasysh, por propozimi juaj nuk mund t'u kufizojë të drejtën atyre kolegëve që duan të diskutojnë në parim. Për këtë arsye, fjalën për diskutimin në parim, ia jap zotit Agalliu.

Arbi Agalliu – Ndoshta po themi të njëjtën gjë dhe nuk po merremi vesh, që ta ndajmë këtë gjë, sepse po kthemi në qesharakë.

Ju, patjetër që thoni se zgjedhjet kanë qenë të lira dhe të ndershme. Ne kemi një pretendim tjetër, duke pasur disa fakte, të cilat janë paraqitur edhe në kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor, sikurse janë patronazhistët, legalizimet, punësimet e kështu me radhë.

Unë kam një pyetje, sepse, me sa shoh, dy pika na ndajnë. Pyetjen e kam të drejtpërdrejtë dhe po ju drejtohem në emër të të gjithë grupit tuaj: Zoti Gogu, si përfaqësues, a jeni dakord që gjithsecili nga ne të thërrasë këdo këtu për të dëshmuar në funksion të marrjes së provave në kuadër të këtij komisioni hetimor? Po apo jo?

Nëse jeni për po, po diskutojmë kot, nëse jeni për jo, bie në kundërshtim me atë ligj që kolegët e thanë. Kjo është një pyetje për të më qartësuar.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Zoti Agalliu, kur të jeni kryetar komisioni, mund të kërkosh përgjigje nga kushdo. Ti bën një pyetje ndërkohë që fjalën e keni për diskutim. Pyetja ngelet në eter, sepse pas teje e ka fjalën për diskutimin në parim zoti Salianji.

Ervin Salianji – Kur marrim fjalën për procedurë, ju si kryetar i komisionit, duhet të mbani paanshmërinë. Nuk mund të merret fjala për procedurë në mënyrë të përsëritur nga përfaqësuesit e maxhorancës dhe të trajtohet dhe të prodhohet jo politikë, por niveli më fundor i akuzave, që jo vetëm janë të pabazuara, por as nuk ekzistojnë më, të merret dhe të drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj përfaqësuesve të opozitës, ashtu siç edhe zëvendëskryetari i komisionit është drejtuar katër herë. Nuk jeni barinj këtu, zotërinj (edhe e kam të drejtpërdrejtë), nuk jeni as mësues i popullit ose na e thoni se mund ta keni edhe këtë pretendim, se deri këtu ka shkuar çmenduria në qeverisje. Na e jepni çfarë të themi ne, edhe ne t'ua themi që t'ju pëlqejë juve. Ne nuk jemi këtu se pëlqejmë njëri-tjetrin. Është e kundërta. Ne jemi këtu sepse partinë tuaj, përfaqësuesit tuaj në parlament, i kemi vendosur nën akuzë, siç i ka vendosur gjithë shoqëria dhe nuk mund të ketë dakordësi mes atij që vjedh dhe atij që është i vjedhur.

Për këtë arsye kërkohen disa rregulla të miratuara dhe të kaluara, jo nga ne, por të kaluara në ligj dhe të miratuara për të bërë të mundur që hetimi të jetë i plotë, i pacenueshëm dhe që të mos tregohet, siç po tregohet nga ana juaj, frika për t'u përballur me provat që do të vijnë nga hetimi i këtij komisioni hetimor.

Gjithë sorollatja me procedurë, me diskutime sikur ka shqetësim, me diskutime gjasje parimore, është që të mos arrijmë të nisim hetimin një orë e më parë.

Shqiptarët sot, ashtu si gjithë opinioni publik, pret që të nisë hetimi në themel dhe të mos merremi me elemente procedurale që ju nuk i keni seriozisht, as propozimet që keni bërë, se u duk qëkur erdhi në orën 9:30 të mbrëmjes propozimi juaj. Veni e vini rrotull vetëm që të fitoni kohë. Hetimin nuk e ndaloni dot.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti Salianji!

Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Zoti kryetar,

E para, duke i qëndruar pikërisht konturit të rregullores, ju me të drejtë nuk e dhatë të drejtën e replikës, nuk kam asnjë ankesë për këtë gjë, sepse, në fund të fundit, ka një tjetër dinamikë funksionimi i komisionit hetimor.

E dyta, këtu ka disa pretendime në disa raste dhe disa didaskalira, të cilët unë personalisht i refuzoj, sepse:

1. Vijnë nga dy standarde, një standard për vete dhe një standard për të tjerët;
2. Janë shumë qesharake në mënyrën se si kërkohen;
3. Janë shumë fëmijërore në mënyrën se si duan ta bëjnë dhe si të tilla duhen evituar.

Kjo nuk është një çerdhe fëmijësh që mund të bëjmë disa didaskali të këtij lloji. Kështu që t'i ruajnë për vende të tjera dhe, po të duan, t'i bëjnë në krahun e tyre kur t'u vijë terezia, në i bëfshin dot zap.

Të hyjmë tek thelbi: është shumë e qartë që ia ka dalë të bëjë një obstruksionizëm, absolutisht, të shkëlqyer. Nuk mund t'ia mohoj njeriu, edhe kundërshtarit duhet t'ia njohësh meritën. I gjithë obstruksionizmi, në emër të zvarritjes, në emër të ridiskutimit të ca standardeve super të konsoliduara. Një pjesë, ata që kanë qenë, ca të tjerë që janë më të rinj, nuk ka rëndës, por është një standard super i konsoliduar, këtu në të dy krahët ka edhe bashkautorë, dhe marrja me elementet e procedurës së Rregullores së një komisioni hetimor, pra kushdo që ka eksperiencë parlamentare, vetëm qesh, meket gazi, sepse është i vetmi domen, i cili ka qenë më i konsoliduari proceduralisht sesa gjithë të tjerët. Nuk ka pasur asnjë ngjarje në këtë çështje. Megjithatë, përsëri u duhet njohur merita! Për të zvarritur ia kanë arritur shumë mirë. Kemi 2 ditë e ca me një çështje, e cila në të gjitha komisionet e tjera hetimore, po të hapni rekordet, është zgjidhur për 5 minuta. Kanë humbur shumë kohë, sigurisht, me diskutime të tjera që ka prodhuar procesi, çështjet hetimore që kanë qenë për t'u diskutuar, por kjo çështje nuk ka marrë kurrë kohë, sepse palët kanë qenë të interesuara t'u shkojnë të vërtetave deri në fund, sipas këndvështrimeve të tyre.

Për sa i takon çështjes së diskutimit në parim, pa asnjë diskutim këtu është dëgjuar një absurditet i paparë që të votojmë një herë e të diskutojmë më pas! Ky do të mbetet një rekord shumë interesant, por, siç ndodhin këto çudira nëpër parlamentet politike, do të jetë edhe kjo një nga çuditë. E kemi këtë rekord të këtij komisioni. Patjetër që mund ta kishim ezauruar këtë çështje të diskutimit, të paktën në parim, edhe në seancën e kaluar, mund të binim dakord dhe këtu do të kishim diskutim direkt vetëm për nenet në tërësi, se do të ishte kohë e fituar. Por është e qartë që nuk ka vullnet. Ka një obstruksionizëm të strukturuar mirë e të tjera. Sa do të shkojë?! Po, ja, do të shkojë edhe sot. Ndonjëherë njeriu, kur ka dëshpërim, nuk di se çfarë bën, bëhet edhe qesharak; është e drejtë e tij.

E treta e këtij obstrukcionizmi është marrja e madhe e kohës për të stabilizuar elementet etiko-morale të drejtimit të komisionit. Ne dimë çdo gjë... Meqenëse i referohen Rregullores së Kuvendit, nëse duan ta referojnë tamam dhe, meqë Kryetarja e Kuvendit, i përdor këto. Kryetarja e Kuvendit thotë: “Është hapur diskutimi, nuk ka më ndërhyrje për procedurë.”. Këtu dëgjojmë 20 herë që, pasi hapet ndonjë diskutim në parim, duan përsëri procedurë. Është vërtet një moment edhe qesharak. Mund të zvarritesh, mund të thuash shumë mirë: “Hajde të marrim gjysmë ore kohë, se nuk duam të flasim më”. Mund të ngrihesh. Ti, si kryetar, nuk e ndalon dot këtë gjë. Por të thuash këtë gjë, ndërkohë që kryetarja e tyre ka tjetër standard. Ajo nuk e ka standardin e saj, se e thotë Rregullorja që, kur hapet diskutimi për një çështje të caktuar, nuk ka më ndërhyrje për procedurë, mund të ndërhyhet edhe 20 herë, pa u hapur diskutimi për çështjet përkatëse.

Për sa i përket rendit të ditës, ka qenë korrekt: shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores. Atë po bëjmë. Po fillojmë ta shqyrtojmë, por si do ta shqyrtojmë?! Në atë rrugë, siç na thotë procedura parlamentare, do ta shqyrtojmë në parim dhe nën për nën. Do ta shqyrtojmë në parim dhe do ta votojmë. Do të fillojmë nën për nën, të gjejmë dakordësi dhe në fund fare do të synojmë që ta miratojmë në tërësi. Po në të gjitha rastet do ta miratojmë me të gjitha votat, se në shumë momente është krijuar ideja që ta hedhim me vrap në votë, se kemi 8 dhe do të mundim 7. Kthjellohuni një herë të vetme! Kjo nuk është punë dëshire, as çështje arrogance numrash. E ka zgjidhur ai që ka bërë ligjin. Doni apo nuk doni në këtë pikë, për këto vendime do të keni dakordësi. Vendime të njëanshme nuk mund të ketë. Ja që procedura parlamentare nuk e paska mundësinë e votimit të njëanshëm. Doni ta bëni?! Po, bëjeni, nuk ka ndonjë problem! Bëni votim të njëanshëm. Janë marrë shumë vendime të paligjshme dhe do të shënohet edhe një rekord tjetër i paligjshmërisë, por ortakë të kësaj nuk bëhemi dot. Këtë thotë edhe diskutimi në parim për rregulloren.

Tani parimet me dy fjali: ky draft pa autorësi, se dëgjova këtu se draft është jo i krahut, jo i kryetarit... Drafti nuk ka autorësi. Është e qartë, është sjellë draft një rregullore tip e komisioneve. Ky draft që është sjellë në parim, elementet parimore, për të vënë në udhë punën e komisionit hetimor, i ka të përfshira brenda. Kjo nuk përjashton diskutimin për nene të caktuara, absolutisht po. Prandaj në parim, unë, personalisht, nuk kam as më të voglën të drejtë të shteroj e t’ju them çfarë duhet të flasin ose jo kolegët. Se çfarë duhet të flasin kolegët, edhe ky është një tjetër rekord nga më qesharakët, por dua ta pranoj si mungesë eksperience. Urdhri politik të fut ngandonjëherë edhe në rrugën e budallëkut, por unë në parim gjej që elemente thelbësore janë ruajtur dhe gjenden brenda.

Po të ishte një propozim që gjente mirëkuptim, ta shteronim sa më parë diskutimin në parim, sepse duket që debat mund të ketë më tepër për çështje që u takojnë neneve të caktuara, ku kemi elemente për të diskutuar. Unë jam dakord në parim që kjo rregullore të miratohet.

Për sa i përket pjesës tjetër, kemi të drejtë të diskutojmë përsëri në debatin nën parim.

Enkelejd Aliabeaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Siç ju dhashë fjalën, po ju jap fjalën... Për replikë thatë ju?!

Për një sqarim, për atë pyetjen që ju bëri zoti Agalliu. Pastaj do të kalojmë në votimin në parim të rregullores.

Po, zoti Gogu.

Toni Gogu – Faleminderit, zoti kryetar!

Kërkesa jonë për të miratuar në parim rregulloren e propozuar nga ju ka 2 orë që pret për t'u hedhur në votim. Keni hapur diskutimin në parim dhe vetëm diskutim në parim të rregullores, që keni propozuar ju, nuk ka. Ka diskutim për propozimet që kemi bërë ne për nene të caktuara, të cilat do të diskutohen kur ne do të diskutojmë nën parim. Është e dukshme që strategjia juaj është që i gjithë minutazhi, që ka kjo mbledhje, të vihet në shërbim të një axhende politike, duke i ftuar deputetët e maxhorancës të shkelin ligjin, të shkelin Rregulloren, gjë të cilën nuk do ta bëjmë.

Vazhdojmë për të tretën herë dhe në mënyrë procedurale kërkojmë: ju lutem, të mos humbasim më kohë me diskutime për propozimet tona për nene të caktuara; hidhni në votim rregulloren që keni propozuar vetë ju, sepse të gjitha diskutimet, që kanë bërë kolegët deri tani, nuk kanë qenë për rregulloren, të cilën keni propozuar ju, por kanë qenë për propozime të caktuara tonat dhe ne do t'i diskutojmë në nene të veçanta.

Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, zoti Salianji, jo.

Atëherë, këto dy orë që janë për diskutimin, janë punë e komisionit, punë e cila do të duhej të ishte bërë ditë më parë, ditë kur ju edhe munguat. Sigurisht, e drejta e çdo deputeti për të diskutuar, është e drejtë që nuk ia heq askush, as kryetari i komisionit, siç e keni vënë re tashmë, që në këto dy orë, të cilat ju mund t'i konsideroni kohë e humbur, në fakt nuk janë kohë e humbur, por koha e ushtruar nga secili prej deputetëve për diskutimin në parim.

Për sqarimin e procedurës, të nderuar kolegë, sipas procedurës dhe Rregullores, do ta hedh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke kërkesë?

Ervin Salianji – Për propozimin që kam.

Enkelejd Alibeaj – Po.

Ervin Salianji – Ne mendojmë se nuk duhet hedhur fare as në votim në parim. Duket se mund të funksionohet fare mirë me Rregulloren e Kuvendit dhe me ligjin “Për komisionet hetimore”. Nuk ka asnjë arsye, përderisa duket qartazi se duan ta hedhim në votim për të hyrë te forca e kartonit, për të kufizuar veprimtarinë e komisionit hetimor. Nuk ka nevojë fare. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Komisioni funksionon sipas Rregullores së Kuvendit dhe sipas ligjit “Për komisionet hetimore”. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Këtu nuk ka dakordësi. S’kemi çfarë hedhim në votim, që t’u bëjmë qejfin dhe të hyjmë në kufizime me anë të votës.

Kështu që, propozojmë të mos e hedhim fare, por të kalojmë në pikën tjetër.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Salianji, së pari, propozimin e kam bërë. Së dyti, ju sqaroj juve dhe këdo tjetër: ky propozim, draft-rregullore, mund të kishte propozime alternative vetëm në rastet kur juve personalisht, zoti Naço personalisht, do të kish depozituar të tjera propozime amendamente. Nuk i kam. Nuk i sollët. Ju mandatuam mbledhjen e parë pikërisht për këtë arsye.

Nuk ka asnjë propozim alternativ. Jam i detyruar ta hedh në parim dhe nen për nen këtë rregullore, pa asnjë alternativë tjetër, veç këtyre dy dispozitave. Ky ishte diskutimi që bëmë edhe në pikën e parë.

Për këtë arsye, hedh në votim në parim, miratimin e draft-rregullores, sipas asaj që kam paraqitur.

Kush është pro?

Miratohet!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Sipas propozimit tim, kush është pro? Kundër?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro?

Miratohet!

Neni 3. Kush është pro? Kundër s’ka.

Miratohet!

Neni 4. Kush është pro?

Miratohet!

Neni 5. Kush është pro? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë pro. Kundër?

Nuk miratohet!

Neni 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Neni 6.

Ju lutem!

Neni 6. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë. Kundër? Nuk ka.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 7. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë. Kush është kundër?

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë.

Miratohet!

Neni 8. Kush është pro? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë.

Kush është kundër? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë.

Miratohet!

Neni 9.

Kush është pro? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë.

Kush është kundër? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë.

Miratohet!

Neni 10.

Kush është pro? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë. Kush është kundër?

Miratohet!

Neni 11. Kush është pro? Kush është kundër? Asnjë.

Miratohet!

Neni 12.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 13. Pro? Kundër asnjë. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 14. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Asnjë.

Miratohet!

Neni 15. Kush është pro? Kundër asnjë. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 16. Asnjë kundër.

Miratohet!

Neni 17.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gogu, jeni duke deklaruar ikjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni duke deklaruar ikjen?

Neni 17. Kush është pro? Kundër asnjë.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 18. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë.

Nuk miratohet, sepse kuorumi ra. Për këtë arsye, deri në këtë dispozitë u miratuan. Nuk kalojmë dot përtej nenit 17, sepse siç e patë, me largimin e zotit Gogu, kuorumi në këtë mbledhje ra, sepse ne jemi shtatë. Për të bërë mbledhjen e vlefshme, do të duhej të ishte së paku edhe një nga anëtarët. Ikja e zotit Gogu bëri që, në mënyrë fizike, edhe kuorumi të binte për këtë arsye. Janë miratuar nen për nen deri në nenin 17.

Në këtë pikë, ajo çfarë unë mund t'ju them, është se deri këtu arritëm në lidhje me Rregulloren. Nga ana tjetër, largimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! 17. Nuk arritëm të miratonim dot edhe pjesën tjetër të neneve e as të bënim miratimin në tërësi. Në qoftë se zonja Mara do të rrijë, ne mund të vazhdojmë. Nëse do të rrini. Do të rrini?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju vjen keq? Dakord!

Çështja tjetër në rend të ditës, ishte edhe caktimi i sekretarit. Sigurisht, për faktin që nuk janë, e drejta e propozimit i takon secilit deputet. Në mbledhjen e parë është bërë një propozim nga ana e zonjës Bushka apo zotit Gogu, të cilët propozuan që të ishte si sekretar i komisionit në zbatim të ligjit, zoti Klevis Xhoxhi.

Duke qenë se kuorumi ra për shkak të largimit të shumicës së këtij komisioni, përfaqësues të Partisë Socialiste, nuk operojmë dot. Për këtë arsye, e vetmja gjë që mbetet e mundshme për të bërë në këtë komision, është pika e fundit: caktimi i datës për mbledhjen e ardhshme.

Unë propozoj që data e mbledhjes së ardhshme të jetë dita e mërkurë, datë 27 tetor, nëse nuk gaboj, sekretaria. Pra, më 27 tetor, ora 11 paradite, në këtë sallë, do të zhvillohet mbledhja e radhës së këtij komisioni.

Ju faleminderit për durimin dhe për kontributin!

MBYLLET MBLEDHJA